Nr. 443 18 MAR 2019

KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.O.
PRISHTINA

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së Bordit te Drejtorëve të KRU "PRISHTINA"SH.A të mbajtur me 18.03.2019 mbledhja e III-të e rregullt.

Bordi i Drejtorëve, pas analizave të bëra të raportit vjetor për vitin 2018 pra Bordi i Drejtorëve merr këtë:

V e n d i m 2019/03-05

1. Aprovohet Raporti i përformancës së kompanisë, për vitin 2018 me inkurajimin dhe sugjerimin për menaxhmentin dhe stafin që të ketë angazhime akoma me te larta qe te arrihet një performancë më e mirë edhe ne vitin 2019 që të afaroi me sukses duke arritur objektivat e KRU "PRISHTINA"SH.A.

2. Kopje e vendimit dhe CD së bashku me raportet ti dërgohet NJPM e NP dhe

3. Komunave : Prishtinë, Besiane (Podujeve), Kastriot (Obiliq), Fushë Kosovë, Drenas, Shtime, Lipjan dhe Graçanic.

Sekretari i Kompanis
Salih Gjonbalaj, Jur. i Dipl.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve:
Amir Gashi, Jur. i Dipl.

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT

“PRISHTINA” SH.A.

RAPORTI VJETOR 2018

GJITHËPËRFSHIRËS

Për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik

Për komunat ne zonën e shërbimit:

1. Prishtinë
2. Fushë Kosovë
3. Obiliq
4. Graqanicë
5. Shtime
6. Lipjan
7. Podujevë
8. Drenas

FINAL

Mars 2019

Prishtinë

Përmbajtja

2. Qëllimi i Raportit vjetor gjithëpërfshirës 6

3. Metodologjia e përgatitjes së Raportit vjetor 6

4. Të përgjithshmet në Raport gjithëpërfshirës 6

5. Raporti vjetor i Bordit të Drejtorëve 7

5.1 Raporti i kryesuesit të Bordit te Drejtorëve 7

5.2 Raporti i pagesës së drejtorëve të Bordit të Drejtorëve 7

6. Raporti vjetor i Menaxhmentit- Kryeshefit ekzekutiv 7

6.1 Performanca operative dhe financiare, krahasimi me vitin paraprak (2017) dhe Planin e biznesit (2018- 2020) 7

6.1.1 Faturimi i shërbimeve bazë (ujë dhe ujëra të zeza) 7

6.1.2 Arkëtimi i i shërbimeve bazë (ujë dhe ujëra të zeza) 8

6.1.3. Prodhimi dhe distribuimi i ujit të pijes në m3 9

6.1.4.Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes 10

6.1.5. Numri i konsumatorëve 11

6.2. Sfidat për vitin pasardhës (2018) 12

6.3.Ngjarjet që priten të ndikojnë në ardhmërinë e ndërmarrjes (në vitin 2019) 13

6.4. Pritjet për vitin aktual (në vitin 2019) 14

6.5. Kapitali i pronarit dhe dividenta 15

6.6.Investimet e realizuara për vitin 2018 15

6.7. Paraja e gatshme 16

6.8. Llogaritë e arkëtueshme 17

6.9.Numri i punëtorëve 18

6.10. Ndërprerjet e ujit (të planifikuara) 18

6.11. Cilësia e ujit të pijes 18

7. Skema Organizative e KRU "Prishtina" 19

8. Raportet e departamenteve sipas skemës organizative 20

8.1. Raporti i sekretarit 20

8.1.1. Shërbimi i administratës gjatë vitit 2018 ka kryer këto veprime: 20

8.1.2. Zyra Ligjore 20

8.2.Raporti i auditorit të brendshëm 21

8.3. Raporti i departamentit të administratës dhe personeli 23

FINAL

8.3.1.Shërbimi për administratë personel dhe burime njerëzore 23
8.3.2.Shërbimi i lekturimit dhe përkthimit (shqip, anglisht dhe serbisht) 23
8.3.3.Shërbimi kontrolli i hyrje-daljeve në objektet e KUR "Prishtina" 24
8.3.4. Raporti i punës së automekanizmit 24
8.3.5. Raporti i punës së zyrës së marrëdhënieve me publikun 25
8.4. Raporti i departamentit për konsumatorë 27
8.4.1. Kërkesat komerciale 27
8.4.2. Kërkesat teknike 28
8.5. Raporti i Departamentit të shitjes 28
8.5.1. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU Prishtinë 32
8.5.2. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU Fushë Kosovë 34
8.5.3. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Obiliq 37
8.5.4. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Graqanicë 39
8.5.5. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Shtime 41
8.5.6. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Lipjan 44
8.5.7. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Podujevë 46
8.5.8. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Drenas 48
8.6. Raporti i departamentit të kontabilitetit dhe thesarit 50
8.7. Raporti i departamentit të prokurimit 53
8.8. Raporti i departamentit të planifikimit dhe zhvillimit 58
8.8.1. Zyra e Sistemit informativ gjeografik (GIS) dhe gjeodezisë 58
8.8.2.Shërbimi i planifikimit 60
8.8.3.Zyra për Planin e biznesit, monitorim të performancës dhe procesin tarifor 61
8.9. Raporti i departamentit të prodhimit 61
8.10. Raporti i departamentit të mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit 63
8.10.1. Shërbimi i rrjetit të Ujit 63
8.10.2. Shërbimi e rrjetit te kanalizimit 64
8.10.4.Shërbimi i makinerisë 64
8.10.5.Shërbimi i elektrikes 64
8.10.6.Shërbimi i elektronikës 65
8.10.7.Stacionet e pompimit dhe rezervuarët në qytet 65
8.10.8.Shërbimi i detektimit te rrjedhjeve 65
8.11. Raporti i departamentit të kualitetit të ujit 66

FINAL

8.12.Raporti i departamentit të mirëmbajtjes dhe trajtimit të ujërave të zeza 68
9. Pasqyrat financiare 71
9.1. Pasqyra e të ardhurave 71
9.2. Pasqyra e pozitës financiare 73
9.3. Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme 74
9.4. Pasqyra e ndërrimeve në ekuitet 75
9.5. Shpalosjet (në Ankes) 76

FINAL

2. Qëllimi i Raportit vjetor gjithëpërfshirës

Me anë të Raportit vjetor (gjithëpërfshirës) për vitin 2018, Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti dhe të punësuarit e tjerë në Kompaninë Rajonale të Ujit "Prishtina" sh.a. pretendojnë të paraqesin të gjitha faktet reale, sukseset, dështimet, vështirësitë, sfidat etj. që e kanë shoqëruar punën e ndërmarrjes prej datës 01.01.2018 deri më 31.12.2018.

Ky raport shërben për të vënë në dijeni me të gjitha aktivitetet qe gjatë viti janë ndërmarrë të gjitha palët e interesit në rend të parë Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në cilësinë e kujdestarit të aksioneve, Autoritetet tjera të pavarura të Republikës së Kosovës, të punësuarit në ndërmarrje, konsumatorët, bankat, donatorët si dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.

Gjithashtu, përmes këtij Raporti, menaxhmenti synon të arrijë transparencë maksimale duke publikuar të gjitha veprimet që e kanë shoqëruar veprimtarinë e punës së ndërmarrjes gjatë vitit 2018.

Parimi themelor që mendohet të arrihet me ketë Raport është edhe llogaridhënia përpara të gjithëve të implikuar si palë e interesit.

Interpretimin e këtij Raporti e bëjnë vetëm hartuesit e tij.

3. Metodologjia e përgatitjes së Raportit vjetor

Raporti është përpiluar duke marrë për bazë përvojat pozitive të Raporteve vjetore paraprake, njohurive empirike si dhe formave dhe formateve të shumta të raportimeve brendshme për menaxhmentin dhe raportimeve të jashtme për palët e interesit.

Me qëllim qe Raporti të jetë i më i thjeshtë, më i qartë dhe më i kuptueshëm për të gjithë, është ndërtuar në bazë të:

- ✓ Pjesës tekstuale, përshkruese - narrative
- ✓ Pjesës se tabelave - shifrave (numrave) dhe
- ✓ Pjesës së grafikeve

Në Raport, një pjesë e shënimeve janë bërë krahasimet (aty ku është e mundur) me vitin paraprak (2017) dhe me Planin e biznesit për vitin 2018.

Raporti merr në konsideratë dhe është përmbledhje përkatësisht sintetizim i raporteve analitike të Departamenteve dhe Autoriteteve të tjera brenda KRU "Prishtina" sh.a.

4. Të përgjithshmet në Raport gjithëpërfshirës

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" sh.a. është ndërmarrje publike qendrore. Veprimtarinë e kryen në bazë të dispozitave pozitive të Ligjeve të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KRU "Prishtina" sh.a. bënë furnizim me ujë të pijes dhe largimin e ujërave të zeza në regjionin e Kosovës qendrore që shtrihet në 8 komuna (edhe një pjesë të vogël të komunës se Vushtrrisë).

FINAL

5. Raporti vjetor i Bordit të Drejtorëve

5.1 Raporti i kryesuesit të Bordit te Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve të KRU "Prishtina" sh.a. gjatë vitit 2018 në tërësi ka kryer me përgjegjësi dhe transparencë veprimet e në kuadër të Ligji Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr.04/L-111 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.03/L-087 për NP dhe Ligji Nr.05/L-009 për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-087 si dhe Kodin e Etikes dhe të Qeverisjes korporativ për NP.

Në këtë periudhë kohore janë organizuar:

- ✓ Organizimin e mbledhjeve te Bordit te Drejtorëve duke përfshirë përgatitjet e Agjendave për mbledhje te BD, përgatitjet dhe zbardhjet e procesverbaleve te mbledhjeve te BD si dhe te gjitha vendimet qe kanë rrjedh nga mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- ✓ Janë mbajtur 13 mbledhje te rregullta te Bordit të Drejtorëve
- ✓ Është mbajtur 1 mbledhje te përgjithshëm me Aksionarin 2018 për raportim te vitit 2017.
- ✓ Janë mbajtur 13 mbledhje te rregullta te Komitetit të Auditimit të Bordit të Drejtorëve
- ✓ Janë mbajtur 2 mbledhjeve të rregullta të Komiteti të Financave.

5.2 Raporti i pagesës së drejtorëve të Bordit të Drejtorëve

Gjatë vitit 2018 pagesat e drejtorëve janë trajtuar në pajtim me Ligjin mbi të ardhurat. Janë tatimuar me shkallën 10 % (punë dytësore).

Pagat neto në bazë të vendimit të Qeverisës së Republikës së Kosovës, në baza individuale janë (vjetore):

✓ Amir Gashi, kryesues i Bordit të Drejtorëve	8.272.12 €
✓ Ardian Syla, kryesues i Komitetit të auditimit në Bordin e Drejtorëve	2.147.12 €
✓ Hasan Zeqiri, drejtor në Bordin e Drejtorëve	5.617.34 €
✓ Shuajb Mehmeti, drejtor në Bordin e Drejtorëve	5.937.96 €
✓ Ilir Rexhepi, drejtor në Bordin e Drejtorëve	6.797.20 €
✓ Driton Gërxhaliu, drejtor në Bordin e Drejtorëve	6.641.59 €
✓ Florim Dvorani, drejtor në Bordin e Drejtorëve	4.852.09 €
✓ Totali i pagesës bruto për Drejtorët e Bordit të Drejtorëve	40.265.42 €

6. Raporti vjetor i Menaxhmentit- Kryeshefit ekzekutiv

6.1 Performanca operative dhe financiare, krahasimi me vitin paraprak (2017) dhe Planin e biznesit (2018- 2020)

6.1.1 Faturimi i shërbimeve bazë (ujë dhe ujëra të zeza)

Përkushtimi i vazhdueshëm i menaxhmentit për të përmbushur detyrat e punës me qëllim të krijimit të standardeve të shërbimit dhe rritjen e substancës së ndërmarrjes ka qenë i vazhdueshëm.

Matja e performancës gjatë vitit 2018 krahasuar vetëm me vitin paraprak ose edhe vetëm me Planin e biznesit nuk na jep rezultat të plotë. Përfshirja e këtyre dy elementeve e rritë vlerën krahasimtare dhe i bënë më të besueshme rezultatet.

FINAL

Shërbimet bazë (shërbimet nga tarifa për ujë dhe ujëra të zeza), përfaqësojnë të hyrat që realizohen nga shërbimet e ujit të pijes, ujërave të zeza (kanalizimit) dhe tarifës fikse.

Në vitin 2017 të hyrat e faturuara kanë qenë në vlerë 14.458.121 €. Në vitin 2018 të hyrat e planifikuara kanë qenë në vlerë prej 15.999.065 € ndërkaq janë faturuar 14.266.089 €. Kjo do me thënë se Plani është përmbushur deri në shkallën 89 %. Në bazë të shënimeve të prezantuara konstatojmë tendencën e njëjtë në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Për më detaje në tabelën në vijim:

Emërtimi	2017			2018			Index 2018 / 2017		
	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index
Faturimi	14,458,121	14,220,393	98%	15,999,065	14,266,089	89%	111%	100%	91%

Paraqitja grafike e numrave duket:



6.1.2 Arkëtimi i i shërbimeve bazë (ujë dhe ujëra të zeza)

Në vitin 2017 nga shërbimet bazë janë arkëtuar 12.335.826 €, ndërsa në vitin 2018 është planifikuar që vlera totale e arkëtimeve të pritshme të jenë rreth 14.486.682 €. Mirëpo gjatë këtij vitin janë arkëtuar 13.736.249 €. Arkëtimi në raport me planin është përmbushur 95 % . Gjithashtu, sipas shënimeve të prezantuara konstatojmë tendencën domethënëse pozitive në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 që paraqet një rritje prej rreth 11 % pavarësisht se kushtet e të bërit biznes nuk janë krejtësisht të njëjta, për shkak se ndikimi i Ligjit për faljen e borxheve publike ka qenë me ndikim sidomos në vitin 2017.

Për më detaje në tabelën në vijim:

Emërtimi	2017			2018			Index 2018 / 2017		
	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index
Arkëtimi	12,335,826	12,347,175	100%	14,486,682	13,736,249	95%	117%	111%	95%

Paraqitja grafike e numrave duket:



6.1.3. Prodhimi dhe distribuimi i ujit të pijes në m3

Gjatë vitit 2017 ndërmarrja për konsumatorët e vetë të ujit ka prodhuar dhe distribuuar 52.087.383 m3 ujë. Ndërsa në vitin 2018 është planifikuar që sasia totale prodhimit dhe distribuimit të jetë rreth 53.823.000 m3. Mirëpo gjatë këtij viti janë janë prodhuar 54.569.918 m3. Prodhimi i ujit ka shënuar ngritje më shumë së plani për 746.918 m3 përkatësisht 1 % më shumë nga vlera e planifikuar e prodhimtarisë. Kjo do me thënë se plani është përmbushur deri në shkallën 101 %. Gjithashtu, sipas shënimeve të prezantuara konstatojmë tendencën pozitive në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 për rreth 5 % të sasisë së përgjithshme faktike. Kushtet e të bërit biznes kanë pasur një ndryshim përmbajtjesor. Në mars të vitit 2017 është lëshuar në punë testuese Fabrika për trajtimin e Ujit në Shkabaj dhe natyrshëm nuk ka punuar të plota 12 muaj ashtu siç ka operuar në vitin 2018.

Për më detaje në tabelën në vijim:

Emërtimi	2017			2018			Index 2018 / 2017		
	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index
Prodhimi m3	49,746,010	52,087,383	105%	53,823,000	54,569,918	101%	108%	105%	97%

Paraqitja grafike e numrave duket:



6.1.4.Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes

Aktiviteti financues është rritur në masë të konsidureshme dhe këtu vlen të theksohen shpenzimet e Zhvlerësimit dhe amortizimit dhe shpenzimet e interesit, shpenzimet e regjistrimit te faturave - kontabilizimin e shpenzimeve të kamatës dhe taksen e ujit të nxjerra për periudhat kohore në të cilat nuk janë regjistruar në vitet paraprake etj.

Gjithashtu, në pasqyrat financiare të vitit 2017 nuk kemi shpenzime të interesit si rrjedhojë e kapitalizimit të aseteve, ku në vitin 2018 ky shpenzim arrin vlerën prej 486,637 euro. Andaj si pasojë e këtyre dy kategorive të shpenzimeve, fitimi neto ka shënuar këtë rënie (pra si rezultat I aktivitetit financues të njohur po në këtë periudhë).

Për më detaje në tabelën në vijim:

Emërtimi	2017			2018			Index 2018 / 2017		
	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index
Shpenzimet O &M	10,393,020	9,243,231	89%	10,344,753	10,654,058	103%	100%	115%	116%



6.1.5. Numri i konsumatorëve

Gjatë 2017 ndërmarrja për shërbimet e veta në fund të vitit ka faturuar për 128.399 konsumatorë. Ndërsa në vitin 2018 është planifikuar qënë fund të vitit shërbime të marrin rreth 132.803 konsumatorë. Mirëpo në fund të vitit shërbime të ujit dhe kanalizimit kanë marrë 132819 konsumatorë. Numri i konsumatorëve ka shënuar një rritje në krahasim me planin me gjendjen e vitit 2017 për 5.329 konsumatorë përkatësisht 2 % më shumë nga numri i faktik për rreth 4.420 konsumatorë. Në vitin 2018 është përmbushur Plani i rritjes së numrit të konsumatorëve në shkllën 100%. Përkatësisht ka pasur një rritje perej 16 konsumatorëve më shumë se Plani.

Për më detaje në tabelën në vijim:

Emërtimi	2017			2018			Index 2018 / 2017		
	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index
Numri i konsumatoreve	130,744	128,399	98%	132,803	132,819	100%	102%	103%	102%

Paraqitja grafike e numrave duket:



6.2. Sfidat për vitin pasardhës (2018)

Menaxhmenti është plotësisht i bindur se këto rezultate nuk janë inkurajuese, sidomos nëse kemi parasysh rritjen e shpenzimeve të operimit. Në këtë rast është e domosdoshme të vihen në dukje edhe veprime, dukuri, suksese dhe gjera të tjera të ndodhura:

- ✓ Shkalla e arkëtimit të shërbimeve të ujit dhe kanalizimi në fund të vitit 2017 ka arritur në 87 %.
- ✓ Shkalla e arkëtimit të shërbimeve të ujit dhe kanalizimi në fund të vitit 2017 ka arritur në 96 %.
- ✓ Përkushtimi i menaxhmentit dhe personelit tjetër për rritjen e shkallës së arkëtimit me theks të veçantënë sektorin e amvisërisë janë shënuar efektet shumë pozitive. Në fakt në fund të vitit 2017 sektori ka arritur deri në shkallën 92,75 % nga totali i faturimeve aktuale të vitit. Përkundër këtyre aktiviteteve dhe angazhimeve të shtuara shkalla e arkëtimit në amvisëri dhe në bizneset e vogla (lokalet) është vlerësuar si e mire por akoma mbetet vend për punë.
- ✓ Ka vazhduar trendi i rritjes së numrit të konsumatorëve për rreth 3 % mbi vlerën e planifikuar përkatësisht 4.420 konsumatorë më shumë se një vit më parë.

- ✓ Shkalla e humbjeve teknike dhe administrative në fund të vitit është shqetësuese
- ✓ Nuk është arritur të bëhet ndarja-identifikimi midis humbjeve teknike dhe humbjeve administrative të ujit. Por duke u nisur nga fakti i leximit masiv të ujëmatësve si dhe numrit të rritur të konsumatorëve konsiderojmë se është bërë një hap vendimtar drejt zvogëlimit të vazhdueshëm të humbjeve komerciale. Këtë na e mundëson përfundimi projektit (donacioni) i Bankës Gjermane dhe kredia nga Banka Gjermane për zhvillim ku janë duke përfunduar investimet në rehabilitimin e rrjetit të ujit në shumë lagje të Prishtinës si dhe në Fushë Kosovë dhe Kastriot. Me përfundimin këtyre investimeve dhe më krijimin e bazës së re të të dhënave presim që të ndikoj direkt në zvogëlimin e humbjeve teknike por edhe komerciale të cilat po vazhdojnë të jenë akoma te larta.
- ✓ Modernizimi i zyrave aktuale për komunikim me konsumatorë dhe të gjitha ambienteve tjera të punës në drejtorinë qendrore, në objektet administrative të Njësive operative të ujit dhe në të gjitha zyrat e arkëtimit në të gjithë zonën e shërbimit. Janë vetëm disa nga punët që janë bërë në përmirësim të cilësisë së shërbimeve dhe efikasitetit në krijimin e kushteve sa më të mira dhe të lehta për konsumatorët tanë të cilët kanë nevojë që të jemi sa më afër tyre dhe të ju mundësojmë qasje të pakufizuar.
- ✓ Vazhdimi dhe funksionalizimi i plotë i marrëveshjes së mirëkuptimit për arkëtimin e faturave në të gjitha sportelet e bankave komerciale, Postes dhe telefonit, Institucioneve mikrofinanciare dhe të gjitha këto pa komisione bankare (qarkullimi bankar brenda të njëjtës bankë).
- ✓ Përshtatja dhe modernizimi në vazhdimësi i softuerit ekzistues në formën e ueb aplikacionit dhe lidhja e drejtpërdrejtë përmes internetit e drejtorisë qendrore dhe Njësive operative të ujësjellësit.

6.3.Ngjarjet që priten të ndikojnë në ardhmërinë e ndërmarrjes (në vitin 2019)

Problemi më i madh që është identifikuar dhe për të zgjidhur të njëjtin duhet mobilizim i shtuar i të gjithë potencialit ekonomik dhe human në ndërmarrje është problemi i ujit pa të ardhura, përkatësisht humbjeve teknike për të zgjidhur të njëjtin duhet mobilizim i shtuar i të gjithë potencialit ekonomik dhe human në ndërmarrje është problemi i ujit pa të ardhura, përkatësisht humbjeve teknike dhe administrative të ujit. Krahas rritjes së sasisë së ujit të përpunuar dhe distribuuar është rritur uji pa të ardhura ndërsa sasia e ujit të faturuar ka mbetur gjithnjë e njëjtë.

Njëjtë edhe me sektorin tjetër publik (ndërmarrjet publike) në Kosovë, sfidë e përhershme e Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të kompanisë mbeten arkëtimi i borxheve të prapambetura të konsumatorëve. Këto borxhe vazhdojnë të rriten prej vitit në vit. Borxhet më të larta të evidentuara deri në përfundim të vitit 2018, janë ato të rasteve sociale dhe komuniteteve pakicë që përfshihen në kategorinë e amvisërisë dhe borxhet e ndërmarrjeve shoqërore që i janë nënshtruar procesit te privatizimit.

Disa herë është biseduar me disa nga Ministritë e Qeverisë së Kosovës e posaçërisht me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të bëjnë diçka në pagesën e borxheve të këtyre kategorive nga Buxheti i shtetit. Këto biseda deri në fundin e vitit 2017, janë mbetur vetëm si dëshirë e mirë e kompetentëve për t'u marrë me këtë problem por ende nuk ka asnjë lëvizje pozitive për të mbuluar shpenzimet e kësaj kategorie të konsumatorëve dhe kategorive të tjera të cilat trajtohen si familje nën përkujdesje të vazhdueshme nga Qeveria (Veteranët, Invalidët civilë dhe të luftës, familjet e dëshmorëve, familjet me të zhdukur nga lufta

etj). Zgjidhja e këtij problemi në fund të vitit 2018 ka marrë një kthesë pozitive. Përkujtojmë se në dhjetor të vitit 2018 në Komitetin ndërministror për ujë është ngritur iniciativa dhe është dërguar në Qeverinë e Kosovës drafti i vendimit për zgjidhjen e këtij problemi.

Komunitetet edhe pse kanë filluar të paguajnë, prapë mbeten brengë e madhe për kompaninë meqë borxhi i komuniteteve sidomos i serbëve është i lartë dhe po dëmton pozitën financiare të ndërmarrjes. Gjithashtu gjatë vitit 2017 ka vazhduar aplikimi i Ligjitpër Faljen e borxheve publike. Ky Ligj, të cilit i është zgjatur afati edhe për 9 muajt e parë të vitit 2017, ka dhënë mundësinë e fshirjes se borxheve te vjetra përpara vitit 2008 dhe ka ndikim të drejtpërdrejt ne rritjen e shkallës së arkëtimit në përgjithësi.

Humbjet teknike dhe administrative të ujit paraqesin problemin më të madh për ndërmarrjen. Përkundër investimeve të mëdha në rrjetin e furnizimit, humbjen e ujit në të njëjta edhe në muajt kur keqpërdorimi i pamatur është fare i vogël na shtyn drejt konstatimit se; humbjet teknike janë ma të larta se ato komerciale. Në fakt humbjet komerciale më lehtë të zbulohen dhe të zvogëlohen veçse nevojitet ndihma direket e Inspektorateve Komunale dhe inspektorëve të kompanisë dhe organeve të drejtësisë (prokuroria dhe gjykatat). Humbjet teknike një trajtim te veçantë sepse duhet investime të cilat nuk varen drejtpërdrejt nga ndërmarrja por edhe nga partnerët tjerë: komunat, Qeveria, donatorët dhe vetë konsumatorët. Ajo që është në kompetencë të kompanisë po bëhet në vazhdimësi dhe rezultati nga kjo është zvogëlimi i humbjeve në shkallën 1% pozitive në secilin vit që pason.

6.4. Pritjet për vitin aktual (në vitin 2019)

Menaxhmenti dhe aksionari gjatë viti 2019 pretendon të shënojë rezultate në të gjithë treguesit financiar dhe teknik. Pritet të jetë një vit i sukseseve të mëdha si:

- ✓ Zvogëlimi i humbjeve te ujit te pa faturuar - Humbjeve.
- ✓ Integrimi rrjetit të ujësjellësit linja e furnizimit për qytetin e Fushe Kosovës
- ✓ Furnizimi i pandërprerë me ujë të pijes për konsumatorët e e qytetit te Fushe Kosovës, dhe integrimi i zonave te Prishtinës qe nuk kane rrjet furnizimi – zonat e reja urbane
- ✓ Projekte tjera infrastrukturore dhe investime kapitale vetanake që përmirësojnë shërbimet ne KRU Prishtina.
- ✓ Rritja e shkallës së arkëtimit , sidomos në sektorin e amvisërisë dhe sektorin e bizneseve të vogla
- ✓ Reduktimin e vazhdueshëm të ujit pa të ardhura dhe identifikimin e humbjeve teknike dhe administrative
- ✓ Mirëmbajtje operative e pajisjeve për përpunimin e ujit
- ✓ Mirëmbajtja dhe operimi ne tërësi i sistemeve te shpërndarjes dhe largimit te ujerave
- ✓ Shfrytëzim racional i makinave të punës
- ✓ Përmbushje e përpiktë e treguesve të parapërcaktuar në Planin të Biznesit 2018-2021
- ✓ Rritjen cilësore të të gjitha shërbimeve administrative
- ✓ Mbështetje cilësore për implementimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza për Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Obilq.
- ✓ Pavarësisht angazhimeve dhe përkushtimit rreziqet e mundshme që gjatë vitit 2018 përkatësisht 2019 mund të ndikojnë negativisht në biznesin e ndërmarrjes dhe që mund të ndikojnë në mospërmbushjen e deklaratave të “misionit” dhe “vizionit” janë:

FINAL

- ✓ Rritja e tarifës së ujit për sektorin e amvisërisë nën poritjet e ndërmarrjes ekzistuese për shkak të rritjes së kostos për shkak të Fabrikës në Shkbaj
- ✓ Zbritja e tarifës volumetrike të shërbimit për konsumatorët e bizneseve dhe institucioneve
- ✓ Zbritja e tarifës fikse të shërbimit për konsumatorët e bizneseve dhe institucioneve
- ✓ Ngritja e kostos së jetesës (rritja e tarifës së energjia elektrike, karburanteve, pjesëve ë ndërrimit etj),
- ✓ Lëvizjet sociale,
- ✓ Futja ne obligime te mëdha kreditore dhe koha e pagesës,
- ✓ Krizat politike,
- ✓ Forcat tjera madhore (tërmeti, vërshimet, zjarret) etj.

6.5. Kapitali i pronarit dhe dividenta

Janë dy kredi të cilat KRU "Prishtina" ka nënshkruar vite më parë: njëra kredi që ka të bëjë me fazën e dytë si është quajtur projekti investiv (Prishtina II) në rehabilitim të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në disa lagje të Prishtinës, Fushe Kosovës dhe Graqanicës. Gjithashtu 2014 është përfituar kredia në vlerë 20.000.000 € për fazën e tretë (Prishtina III) KFW-së. Kjo kredi është siguruar me qëllim të implementimit të fazës së tretë që ka të bëjë më dertimin e fabrikës së re të ujit në Shkabaj.

Anuiteti i parë i kësaj kredie është paguar me 30 nëntor 2015, vlera e anuitetit pa interes ka qenë 1,111,000 € si dhe taksat menaxhuese dhe interesin, obligime këto që priten të jenë sfiduese dhe domosdo do të detyrojë që të racionalizojmë shpenzimet operative por edhe investimet.

Gjatë vitit fiskal 2018 KRU "Prishtina" sh.a. ka paguar edhe dy këste të anuiteteve pikërisht me datën 29.05.2018 në vlerë 1.111.000 € dhe me datën 14.11.2018 po ashtu në vlerë prej 1.111.000 €.

6.6.Investimet e realizuara për vitin 2018

Investimet e realizuara për vitin 2018 do ti prezantojmë në tabela kumulative. Investimet e vitit 2018, janë tejkaluar krahasuar me Planin e biznesit dhe pritjeve të Bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit. Tejkalimi i kësaj kategorie është kryesisht si rezultat i mos kapitalizmit të një numri të caktuar të projekteve që kanë qenë të ndërlidhura në financim prej kredive të ndërmarrjes nga njëra anë dhe komunave dhe donatorëve të ndryshëm nga ana tjetër.

Emërtimi	2017			2018			Index 2018 / 2017		
	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index
Investimet kapitale	1,942,806	370,903	19%	1,324,000	3,378,481	255%	68%	911%	1337%

Paraqitja grafike e numrave duket:



6.7. Paraja e gatshme

KRU "Prishtina" sh.a. gjatë vitit 2018, siç u tha edhe më lartë ka pasur të hyra të arkëtuara rreth 13.739.249 €, pavarësisht këtij fakti gjendja e parasë së gatshme në fund të vitit 2018 vlera e saj është më e madhe në krahasim me vitin paraprak për 165.236 € përkatësisht 10 %. Nd ërsa në krahasim me Planin e biznesit për vitin 2018 sasia e parasë së gatshme është më e madhe për 584.286 € përkatësisht për 49 %. Për një gjendje të tillë ka ndikuar shkalla e lartë e arkëtimit të faturave si dhe ndikim negativ ka pasur pagesa e dy anuiteteve të kredisë për Projektin Prishtina III në vlerë 2.222.000 €, pagesa e kamatave për kredi si dhe borxheve të prapambetura për shfrytëzimin e ujit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Emërtimi	2017			2018			Index 2018 / 2017		
	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index
Paraja e gatshme	232,941	1,604,050	689%	1,185,000	1,769,286	149%	509%	110%	22%

FINAL

Paraqitja grafike e këtij elementi ka këtë dukje.



6.8. Llogaritë e arkëtueshme

Trendi i rritjes së shkallës së arkëtimit prej vitit në vit nga njëra anë si dhe niveli i njëjtë i rritjes së faturimeve përkatësisht të hyrave nga shërbimet bazë ka ndikuar në zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme përkatësisht në rritjen shumë të lehtë të këtyre. Natyrisht duke u zvogëluar llogaritë e arkëtueshme janë rritur paratë e gatshme ose format tjera të aktivit të ndërmarrjes.

Në vitin 2017 llogaritë e arkëtueshme kanë qenë në vlerë prej 55.698.564 € ndërsa në vitin 2018 këto llogari janë rritur për rreth 1 % ose në vlerë prej 785.950 € duke llogaritur edhe rezervimet për "borxhet e këqia" në fund të vitit 2018 kanë arritur vlerën në 56.484.514 €.

Gjendja e llogarive të arkëtueshme (bruto)

Gjendja e llogarive të arkëtueshme (bruto)	2017	2018	Ndryshimi Euro	Ndryshimi %
Faktike	55,698,564	56,484,514	785,950	101%

6.9.Numri i punëtorëve

KRU „Prishtina“ sh.a. të gjitha veprimet operative dhe financiare i ka kryer 559 të punësuar. Kjo shifër ka mbetur nën planifikim, sepse te planifikuar ne Planin e Biznesit kane qene 560 punëtorë.

Menaxhmenti ka qenë i kujdesshëm dhe nuk e ka kaluar numrin e lejuar të punësimeve të përcaktuar me Planin e biznesit (560 punëtorë), por ka arrit të stabilizoj shifrën e punësimit.

Por gjatë vitit 2018 kompania po ashtu kishte angazhuar edhe 20 punëtorë shtese për shërbime te rojës dhe sigurisë nga shkaku i dështimit te tenderimit te shërbimeve te sigurimit fizik. Këta punëtorë janë te angazhuar me kontrate mbi vepër për një vit

6.10. Ndërprerjet e ujit (të planifikuara)

Ka vazhduar trendi i furnizimit i më i mirë ne krahasim me vitet paraprake si rezultat i shtimit te sasisë se ujit edhe në krahasim me Planin e biznesit si dhe me vitin paraprak. Në fakt duke iu falënderuar rezervave të ujit në Liqenet akumuluese ka pasur përmirësime mirëpo reduktimet në kuotat e larta të kryeqytetit si dhe gjatë muajve e ditëve me temperatura ekstreme është vërejtur një mungesë shumë e vogël e ujit te pijes. Janë ndërmarrë veprime që koha e furnizimit të qytetarëve me ujë te rritet. Zgjerimi dhe rritja enorme e popullatës në pjesët urbane te qytetit por edhe në ato periferike (shiko numrin e rritjes së konsumatorëve) ka ndikuar që koha e furnizimit me ujë të mbahet në nivel.

6.11. Cilësia e ujit të pijes

Qëllimi kryesor i Departamentit është organizimi dhe funksionimi i tij si Departament për Kontrollin e Kualitetit të ujit duke u bazuar në Standardet cilësore, aplikative (U.A.16/2012) dhe ato evropiane (Udhëzimi –Direktiva 98/83/EC) mbi kualitetin e ujit për përdorim nga njerëzit (me parë direktiva 80/778/EEC). Kjo direktivë përcakton dallimet në mes të parametrave mikrobiologjik dhe atyre fiziko-kimik. Aplikimi i standardeve është në interes të të gjithë konsumatorëve në Prishtinë, Shtime, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Podujevë, Drenas dhe Graçanicë. Departamenti i Kualitetit të Ujit me planin e tij të monitorimit brendshëm të kualitetit të ujit ka në procedurë pikë së pari mbledhjen marrjen e mostrave të ujit të përpunuar nga rrjeti i ujësjellësit, aeratorëve, liqeneve , puseve dhe lumenjve.

FINAL

7. Skema Organizative e KRU “Prishtina”



8. Raportet e departamenteve sipas skemës organizative

8.1. Raporti i sekretarit

Është siguruar bashkëpunim i ngushtë me Bordin e Drejtorëve, zyrtarët e lartë dhe të gjithë të punësuarit e ndërmarrjes. Në kuadër të këtij bashkëpunimi nuk është kursyer në organizimin e konsultave, këshillimeve profesionale në nivelin më të lartë te mundshëm. Gjithashtu është punuar në:

- ✓ Organizimin e mbledhjeve te Bordit te Drejtorëve duke përfshirë përgatitjet e Agjendave për mbledhje te Bordit të Drejtorëve, përgatitjet dhe zbardhjet e procesverbaleve te mbledhjeve te BD si dhe te gjitha vendimet që janë nxjerrë,
- ✓ Organizimin e mbledhjeve te rregullta të Komiteti te Auditimit, përgatitjet e Agjendave te Komitetit të Auditimit, përgatitjet dhe zbardhjet e procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit të auditimit.
- ✓ Organizimin e mbledhjeve te rregullta te Komiteti te Financave.
- ✓ Organizimin e mbledhjeve te rregullta te Komitetit për Hulumtim te Teknologjisë.
- ✓ Organizimin e mbledhjeve te rregullta te Komitetit për Staf dhe Shpërblime.
- ✓ Mobilizime dhe mbikëqyrje te veçanet si te Administratës dhe te Zyrës Ligjore.

8.1.1. Shërbimi i administratës gjatë vitit 2018 ka kryer këto veprime:

- ✓ Organizimi i personelit dhe administratës,
- ✓ Është punuar nga rasti në rast sipas kërkesave të menaxhmentit të ndërmarrjes
- ✓ Është punuar sipas kërkesave të punëtoreve te ndryshëm për çështje të ndryshme: punë profesionale, qasje në dosje personale për nevoja të ndryshme dhe plotësim të dokumentacioneve për nevoja të ndryshme e të paspecifikuara, vjetore deri tek krijimi i marrëdhënies se punës.
- ✓ Administrimi i autoparkut ne përgjithësi.

8.1.2. Zyra Ligjore

Zyra Ligjore ka procesuar të gjitha kërkesat të cilat i janë adresuar kësaj zyre duke u kujdesur për respektim të afateve ligjore për të gjitha shkresat dhe parashtresat e pranuara. Në vijim paraqesim të dhënat e shprehura në statistikë për të gjitha punët e kryera gjatë vitit 2018.

Të dhënat rreth seancave të mbajtura gjatë periudhës raportuese:

Numri i seancave gjyqësore	Seanca për borxh	Seanca për kompensim dëmi	Seanca për Vërtetim Pronësie	Konteste tjera
70	47		1	22

Të dhënat rreth rasteve të dërguara të Përmbaruesit Privat gjatë periudhës raportuese:

Numri i lëndëve të dërguara të përmbaruesit Privat	Shuma totale e borxhit për këto lëndë	Shuma e inkasuar për periudhën raportuese	Shuma e paguar për taksë
72 lëndë	80,400.31 €	6,469.69 €	900.91 €

FINAL

Përveç shumës së arkëtuar nga lëndët e procesuara për përmbarim, janë arritur marrëveshjet për pjesët e mbetura të borxhit nga konsumatorët të cilat duhet të konsiderohen si të hyra nga rezultati i procesimit për përmbarim. Të dhënat për dorëzimin e Përgjegjës në Padi për të cilat KRU "Prishtina" sh.a., ka qenë e Paditur:

Numri i Përgjigjeve në Padi	Kompensim Dëmi	Faturim/Borxh
11	4	7

Gjatë periudhës raportuese janë dorëzuar 4 (katër) Ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Ndërmarrjet Shoqërore që kanë kaluar në proces të privatizimit: "VETFARM", "Rilindja", "Drithnaja" dhe "Jugobanka".

Dy raste janë mbyllur në të cilat KRU "Prishtina" sh.a. ka qenë e Paditur:

1. Kompanisë "Proing" nga Drenasi në Nëntor 2018 i është paguar shuma në vlerë prej 13,716.00 € për punët e kryera në objektin Administrativ në Prishtinë.

2. Palës Paditëse Mehmet Rama dhe Bedri Rama nga Podujeva i është paguar shuma në vlerë prej 54,732.23 € për shkak të humbjes së jetës se fëmijut te tyre në një puset – Podujevë.

Gjatë periudhës raportuese janë tërhequr 11 (njëmbëdhjetë) lëndë për borxh nga Gjykata Themelore Prishtinë pasi debitorët kanë paguar një pjesë borxhit prej 737.63€ dhe taksën gjyqësor 105.00€ si dhe për pjesën e mbetur kanë hyrë në ri-programim.

Po ashtu edhe nga lëndët e tërhequra nga Gjykata rezultojnë në marrëveshje të konsumatorëve të proceduar përmes gjykate, të cilët kanë paguar një pjesë të borxhit, kanë lidhur marrëveshje dhe kanë paguar taksen gjyqësore.

Po ashtu, në kuadër të aktiviteteve të Zyrës Ligjore janë kryer edhe punë të ndryshme administrative sipas kërkesës si: Caktimi në Komisione, mbajtja e kontaktit të vazhdueshëm me Përmbaruesit Privat në lidhje me debitorët, sqarimi i konsumatorëve të cilët kanë ardhur për konsulta në Zyrën Ligjore për çështje të ndryshme si dhe përgjigja në shkresa të ndryshme adresuar kësaj zyre.

8.2.Raporti i auditorit të brendshëm

Në zbatim të dispozitave Ligjore, Zyra e auditorit të brendshëm aktivitetet e saj të auditimit të brendshëm ne ndërmarrje i kryen në bazë të Planit vjetor të aprovuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Në raste te veçanta është azhurnuar dhe kërkuar nga Komiteti i Auditimit dhe auditime më kërkesa të tyre ku detalet janë prezantuar më poshtë.

Për të parë një pasqyre te qartë te aktiviteteve te Zyrës për vitin 2018, më poshtë i kemi evidentuar në tabelën përmbledhëse tët të gjitha raporteve të Zyrës.

FINAL

I. Aktivitetet e ZAB-se bazuar nga Plani Vjetor i Auditimit te brendshëm.

Nr.	Përshkrimi përmbledhës i Auditimit	Objektivi i detyrës	Indexi i rrezikut	Prioriteteti	Koha e realizimit	Ditë punë
1.	Vëzhgimi gjatë regjistrimit të mjeteve themelore	Për ta monitoruar dhe përcjellur procesin e komisionit të regjistrimit të mjeteve themelore për gjendjen në fund të vitit.	2.00	M	04.01.18 31.01.18	20
2.	Burimet njerëzore - Personeli	Për tu siguruar se procesi i pranimit të punëtorëve të rinj është kryer konform rregulloreve të brendshme dhe ligjeve si dhe verifikimi i pagave mujore.	2.00	M	05.02.18 16.03.18	30
3.	Auditimi i pasqyrave financiare dhe verifikimi i hapjes së librave	Verifikimi i azhuritetit të regjistrimeve kontabël, verifikimi i pohimeve të regjistrimeve. Moduli i librit kryesor, bilanci provues sipas njësive, bilanci provues i konsoliduar, PA, PRRP, PN në Ekuitet dhe Shpalosjet.	3.00	L	13.03.18 25.04.18 Vertetim 12.07.18 26.07.18	31 10
4.	Auditimi i Stoqeve (Depos)	Për tu siguruar që stoqet kanë evidenca të mirëfillta për hyrjet dhe daljet nga depoja, gjendja e tyre përputhet më librin kryesor si dhe ruhen në kushte të mira.	3.00	L	07.05.18 01.06.18	20
5.	Të hyrat (auditimet e shitjeve)	Për tu siguruar që shitjet (faturimi) për klientelën kryhet korrekt sipas leximit dhe më kohë për secilin muaj të vitit.	3.00	L	04.06.18 13.07.18	30
6.	Paraja e gatshme	Për tu siguruar se të gjitha transaksionet më paranë e gatshme kryhen sipas rregulloreve të brendshëm dhe ligjeve në fuqi, gjendja në librin kryesor përputhet më gjendjen në ekstraktet bankare.	3.00	L	17.07.18 04.09.18	25

FINAL

7.	Llogarit e Arketueshme	Verifikimi dhe njëkohësisht sigurimi i se evidencat e llogarive te arketueshme ne kompaninë mbahen korrekt dhe konform me SKK.	3.00	L	10.09.18 20.10.18	30
8.	Prokurimet/blerjët	Për tu siguruar se prokurimet janë bërë në bazë të ligjit të prokurimit publik në mënyrë efikase dhe me kohë.	3.00	L	22.10.18 20.12.18	43

Të gjitha raportet e shënuara më lartë janë kryer konform afateve të parapara në Planin e auditimit me përjashtim te ndryshimeve që është dashur që sipas prioritetit të kryejmë punët me kërkesë të Komitetit të Auditimit. Të gjitha raportet si drafte janë diskutuar me menaxhmentin, janë aprovuar në Komitet tëAuditimit dhe pastaj janë dërguar përmes sekretarit në NJPMNP.

Zyra e Auditorit të Brendshëm është angazhuar në vazhdimësi me personelin e ndërmarrjes në raport me konsulenca të ndryshme sipas nevojave ditore për të cilat nuk është lëshuar raport.

8.3. Raporti i departamentit të administratës dhe personeli

Gjatë vitit 2018 janë mbajtur mbledhje të rregullta me zyrtarët e Departamentit të Administratës me qëllim të adresimit të detyrave ditore, informimit rreth punëve të kryera dhe problemeve eventuale. Është bërë kontrollim i vazhdueshëm i shkresave të përgatitura nga zyrtarët, kontrolli i vazhdueshëm ne te gjitha shërbimet nën përgjegjësinë e Departamentit të Administratës si dhe takime të ndryshme për koordinim të punëve brenda ndërmarrjes dhe institucioneve tjera.

8.3.1.Shërbimi për administratë personel dhe burime njerëzore

Është punuar edhe nga rasti në rast, sipas kërkesave të menaxhmentit të Kompanisë, sipas kërkesave të punëtorëve të ndryshëm për çështje të ndryshme, të kandidatëve të ndryshëm pjesëmarrës nëpër konkurse si: për punë profesionale, qasje në dosje personale për nevoja të ndryshme dhe plotësim të dokumentacioneve për nevoja të ndryshme e të paspecifikuara.

Ne zyrën e Arkivit dhe arkivimit elektronik te dokumentacionit, nga muaj Tetor janë skanua dhe arkivua në elektronikë dokumentacion nga DPZH, DPA dhe departamente tjera, ku janë skanua diku rreth 520 dokumente.

8.3.2.Shërbimi i lekturimit dhe përkthimit (shqip, anglisht dhe serbisht)

Gjatë vitit 2018 në një periudhë 1 vjeçare janë përkthyer gjithsejtë 210 shkresa të ndryshme të cilat janë:

- ✓ komunikata të ndryshme për shtyp,
- ✓ lajme për web faqe,
- ✓ rregullore të brendshme te kompanisë,
- ✓ raporte të kënaqshmërisë së konsumatorëve,
- ✓ përkthim në gjuhën shqipe të ankesave të konsumatorëve serb,
- ✓ përkthime të vendimeve të komisionit për konsumatorët serb për Departamentin e shërbimit për konsumatorë

- ✓ formularë të ndryshëm për nevojat e këtij shërbimi gjatë faljes së borxheve publike,
- ✓ konkurse të ndryshme të shpallura nga kompania
- ✓ përkthimi i propozimeve si dhe prapsimeve të kundërshtimit për Zyren ligjore,
- ✓ Vendime të Bordit, përkthime për Departamentin e prokurimit

8.3.3.Shërbimi kontrolli i hyrje-daljeve në objektet e KUR ”Prishtina”

Organizimi, strukturimi dhe funksionimi i shërbimit të sigurimit ne mase te madhe përcillet me dokumentacion procedural (raporte nga më të ndryshmet dhe atë raportet ditore, javore, mujore, raportet e incidenteve, ditarët, vlerësimet e punëtoreve etj.) dhe formularët e nevojshëm për dokumentimin dhe kryerjen sa më efikase të punës së sigurimit në KUR ”Prishtina” (formularë pranim-dorëzimi i ndërrimit, evidencës së qelsave, formularët e incidenteve, formularët e deklaratave, formularët e oreve mujor, formularët për vizitorë vendorë dhe të jashtëm, formularët për evidencë të hyrje-daljeve të automjeteve, pajisjeve, të mirave materiale, formularët për kontrolle të automjeteve, formularët për leje-hyrje në objekte të KUR ”Prishtina” etj.

Shërbimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes është i organizuar nga punëtorë te rekrutuar nga KRU „Prishtina“.

Aplikon procedurat e kontrollit të hyrjes dhe daljes së personelit të KUR ”Prishtina” si dhe vizitorëve dhe kontraktorëve

Kontrollimi i posedimit te mjeteve themelore për mbrojtje dhe siguri ne pune, ku është bere vizite ne vend punimet e punëtoreve, ne pikat punuese ne teren dhe vizite objekteve ne qytet si dhe vizite njësive operative te Kompanisë,

8.3.4. Raporti i punës së automekanizmit

Shërbimi i Auto-mekanizimit të kompanisë KUR “Prishtina” disponon me 111 automjete dhe makina speciale. Me këto pajisje kryhen punët ne Mirëmbajtjen e rrjetës se ujësjellësit dhe kanalizimit në 8 komuna dhe plotësimin e nevojave transportuese për kompaninë: bartja e punëtorëve ne relacionin Prishtinë-Albanik dhe Prishtinë-Badovc

Shërbimi i auto-mekanizmit organizon punën e automjeteve dhe makinave të kompanisë nga ku ipen urdhëresat e punës.

Gjithashtu nga ky shërbim behet përcjellja e kilometrave përmes “GPS” sistemit.

Gjatë vitit 2018 automjetet udhëtarëve dhe automjetet speciale që kanë bërë punë të ndryshme në interes të qytetarëve kanë lëvizur ose punuar në vend (ekskavatorë, kamion, sharra etj) sipas ;

Mbrojtja dhe siguria në punë- prej fillimit te muajit Janar është bere kontrollimi i posedimit te mjeteve themelore për mbrojtje dhe siguri ne pune, ku është bere vizite ne vend punimet e punëtorëve, ne pikat punuese ne teren dhe vizite objekteve ne qytet si dhe vizite njësive operative te Kompanisë, ku është munduar qe te konstatohet një gjendje faktike e posedimit dhe kushteve te mjeteve te punës.

Emertimi	Vizitat e kryera ne teren per vitin 2018	42

FINAL

Furnizimi me mjete themelore te punës te sezonit ka qene ne nivel shumë te mire si dhe ka vazhduar dhe shpërndarja e tyre ku përfshihen: Rrobat e punës se verës, rroba pune dimri, jakne dimri, çizme pune gome, doreza lëkure gome, doreza PVC, mantel laboratori, këpucë gome, etj.

8.3.5. Raporti i punës së zyrës së marrëdhënieve me publikun

Zyra për marëdhënie me publikun përmes këtij raporti, paraqet një pasqyrë të përgjithshme mbi mbulueshmërinë mediale për vitin 2018. Raporti vjetor përshkruan shkurt dhe saktë , mbulueshmërinë mediale dhe fokusin medial për muajt raportues 2018.

Praktika e marrëdhënieve me publikun është përpjekja e planifikuar për të krijuar dhe mbajtur vazhdimisht vullnetin e mirë dhe mirëkuptimin mes një organizate dhe publikut të saj.

Në vazhdimësi, kjo zyrë e njofton publikun e saj për zhvillimet më të fundit.

Tash për tash, mënyra më e sukseshme e plasimit të veprimtarisë së një institucioni, apo porosisë së po atij institucioni, është bashkëpunimi me mediat. Kjo zyrë brenda një ditë pune, ka zhvilluar komunikim të ndërsjellë me media elektronike dhe të shkruara, duke raportuar, deklaruar dhe realizuar intervista të ndryshme lidhur me aktivitetet e KRU ”Prishtina” sh.a. në interes të publikut dhe anasjelltas, por duke mos e anashkaluar asnjëherë edhe komunikimin me palë të treta, siç janë, niveli qendror, lokal dhe ai ndërkombëtarë.

Qëllimi i këtij raporti është nxjerrja në pah e aktiviteteve vjetore të Kompanisë, përcjellja e mesazheve në opinionin publik përmes mediave, duke i njoftuar drejtorët e bordit, kryeshefin ekzekutiv, zëvendëskryeshefin , zyrtarët e lartë dhe menaxherët.

Zëdhënësi është munduar që nga fillimi i vitit 2018, që porosinë që del nga KRU,,Prishtina,, , përmes mediave elektronike dhe të shkruara ta bartë te opinioni publik, gjegjësisht te konsumatorët e saj, në mënyrë të shpejtë, të ndershme dhe të saktë /etika gazetareske/, duke mbrojtur interesat e kompanisë në tërësi dhe konsumatorit në veqanti.

Mediat nacionale i kanë kushtuar hapësitë të mjaftueshme KRUP-së, kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen e shkallës së arkëtimit, vetëdijësimin e konsumatorëve për pagesa të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe kursimin e ujit të pijshëm.

Fushat e komunikimit publik,

- Furnizimi me ujë të pijshëm,
- Cilësia e ujit të pijshëm,
- Arkëtimi,
- Borxhet,
- Ujëmatësit dhe faturimi,
- Investimet në infrastrukturën e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Donatorët,
- Shkyçjet individuale,

- Takimet zyrtare me ndërkombëtarë,
- Takimet zyrtare me nivelin qeveritar dhe lokal, etj.

Komunikata për media,

Komunikata për media, nuk është gjë tjetër përveq se një lajm, i shkruar nga zyra për marrëdhënie me publikun, lidhur me aktivitetin momental përkatës të institucionit, për të cilin punon ajo zyrë. Kompania Rajonale e Ujësjellësit ,,Prishtina,, që nga muaji i parë e deri në muajin e fundit të vitit 2018, ka përgatitur pothuajse çdo të tretën ditë nga një komunikatë, për web faqen e kompanisë, rrjetin social facebook të kompanisë dhe të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara.

Komunikatat, gjegjësisht kumtesat apo njoftimet për media, kanë qenë forma më efikase e plasimit të informacionit në interes të konsumatorit.

Fokuset mediale përgjatë muajve janar - dhjetor 2018,

Janar 2018 - Shkyçjet nga shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, gjithnjë e më intensive / shkak mospagesat e rregullta!,

Shkurt 2018 - Takime bashkëpunimi me Komuna, Shkyçjet individuale dhe gjendja e furnizimit me ujë të pijshëm,

Mars 2018 - Rrjedhjet e brendshme, takim me konsumatorë dhe Dita Botërore e Ujit 22 mars,

Prill 2018 - Punime teknike, takime me Ministri dhe Komuna, fshati Orllan dhe mundësia e kyçjes në sistemin e ujësjellësit,

Maj 2018 - Faturimi i konsumatorëve në ndërtesa të banimit kolektiv në rastet me ujëmatës të përbashkët, KRU,, Prishtina ,, sh.a., Kompania Rajonale e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve në Republikën e Kosovës me Performancën më të mirë për vitin 2017,

Qershor 2018 – Vazhdimi i shkyçjeve, Inaugurimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza,

Korrik 2018 - Vërshimet në qytetin e Prishtinës pas reshjeve atmosferike dhe çështja e ujërave fekale (kanalizimeve), Ujësjellësi i Budapestit vizitoi Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit,,Prishtina,,

Gusht 2018 - 1185 shkyçje individuale nga sistemi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për 6 muaj!,

Shtator 2018 – Punime teknike dhe njoftime për konsumatorë,

Tetor 2018 - Komuna e Prishtinës (si institucion) me borxh të madh ndaj shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, punime teknike dhe falënderime për konsumatorë,

Nëntor 2018 – Konferenca e ujërave në Tiranë, punime teknike, takime zyrtare me komunën e Shtimes e të tjera,

Dhjetor 2018 – Takim / Konferencë me drejtorë dhe pronarë të mediave, kërkesë konsumatorëve për pagesa të rregullta të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, etj.

FINAL

8.4. Raporti i departamentit për konsumatorë

Në Departamentin e Konsumatorëve aktivitet dhe punët gjatë periudhës njëvjeçareje vitin 2018 kanë qenë të fokusuara në përmbushjen e detyrave si dhe realizimin e prioriteteve për arritjen e rezultateve ne Shërbimin e konsumatorëve .

Të gjithë zyrtarët në këtë shërbim kanë qenë maksimalisht të angazhuar në përmbushjen e të gjitha detyrave.

- Pranimi dhe ofrimi i shërbimit për konsumatorët –konsultime
- Pranimi i kërkesave –ankesave komerciale për amvisëri dhe biznese
- Pranimi i kërkesave –ankesave teknike
- Inspektimi në teren për ankesat komerciale
- Shqyrtimi i kërkesave –ankesave komerciale për amvisëri dhe biznese
- Hartimi i vendimeve për lëndët e përfunduara
- Dorëzimi i vendimeve përmes zyrtarëve kompetent deri te konsumatori
- Skenimi i lëndëve, ngarkimi në programin CRM-së si dhe arkivimi i të gjitha lëndëve të përfunduara
- Takimi me ARRU-në
- Kontrollimi i lëndëve për falje të borxheve si lëndëve të tjera
- Thirrja e konsumatorëve me borgje të riprogramimit për pagës

Pranimi dhe ofrimi i shërbimit për konsumatorët –konsultime

Me kërkesat e ndryshme të konsumatorëve , ju kemi ofruar të gjitha informatat e kërkuara përmes programit të CRM-së apo ndonjë forme tjetër , në mënyre që konsumatori të jetë i kënaqur .

8.4.1. Kërkesat komerciale

Pranimi dhe inspektimi i kërkesave –ankesave komerciale për amvisëri dhe biznese

Në kuadër te pranimit te kërkesave –ankesave gjatë vitit 2018 kemi pranuar dhe trajtuar të gjitha kërkesat-ankesat si

✓ Kërkesa- ankesa për mbi faturim, mos lexim të UM, pagesa, mos dërgim të faturave	
✓ Kërkesa për ndërrim të emrit të konsumatorit	1471
✓ Kontratat për Ofrimin e Shërbimit për konsumatorë	2713
✓ Kontrata për riprogramime	820
✓ Anulim i kontratave të riprogramuar pas pagesës së borxhit të mbetur	203
✓ Inspektim I ankesave –kërkesave për verifikimin e gjendjes në teren	1483
✓ Totali:	8092

Pranimi i kërkesave –ankesave teknike

Në kuadër të pranimit të kërkesave –ankesave gjatë gjithë vitit kemi pranuar kërkesa-ankesa si:

FINAL

- ✓ Kërkesa për Kushte teknike, kyçje të reja , DPZH 1005
- ✓ Kërkesa për regjistrim -verifikim, bazhdarim, ndërrim të UM etj. 1668
- ✓ Kërkesa për mungese të ujit apo shtypjes/DO - 25
- ✓ Kërkesa për mirëmbajtje të rrjetit ,kanalizimit /DO 25

2723

8.4.2. Kërkesat teknike

Shqyrtimi i kërkesave –ankesave komerciale për amvisëri dhe biznese

Për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve kanë punuar dy komisione

Komisioni për shqyrtimin e lëndëve për amvisëri .

Komisioni për shqyrtimin e lëndëve për biznese ,

Nga gjithësej lëndë të shqyrtuara për kategorinë e amvisërisë janë:

- ✓ Kërkesa te aprovuara 636
- ✓ Kërkesa te refuzuara 141
- ✓ Ankesa te aprovuara 89
- ✓ Ankesa te refuzuara 525

Nga gjithsej lëndë të shqyrtuara sipas kategorisë së biznesit janë:

- ✓ Kërkesa te aprovuara 146
- ✓ Kërkesa te refuzuara 40
- ✓ Ankesa te aprovuara 11
- ✓ Ankesa te refuzuara 51

Qendra e thirrjeve (Call Center) Kemi pranuar 244 thirrje .

Departamenti i konsumatorëve ka kryer edhe shërbime të tjera gjate vitit 2018 , po i cekimit vetëm disa

Lëndë të kontrolluara nga falje e borxheve gjithsej 21071 lëndë.

Kemi bere thirrje telefonike për konsumatorët me borxhe të riprogramimit gjithsej 1,791

Kontrollimi dhe futja e të dhënave personale në data bazën që nga viti 2010-2014, 12,347

Verifikimi I konsumatorëve për pagesa sipas listës së pranuar nga menaxhmenti 7,099

8.5. Raporti i Departamentit të shitjes

Departamenti i shitjes përbën shtyllën kryesorë të mirëfunksionimit të ndërmarrjes. Të gjitha veprimet financiare hyrëse në ndërmarrje fillojnë dhe përfundojnë në kuadër të Departamentit të shitjes.

Departamenti në esencë, thënë shkurt merret me këto veprimtari:

- ✓ Leximi i matësve të të gjitha llojeve të konsumatorëve

FINAL

- ✓ Përllogaritja dhe shpërndarja e faturave
- ✓ Inspektimi dhe kontrolli i matësve
- ✓ Regjistrimi i dëftesë arkëtimeve nga konsumatorët.

Në tabelën në vijim po paraqesim numrin e faturave të përllogaritura dhe shpërndara te konsumatorët për shërbimet bazë.

Emërtimi	2017			2018			Index 2018 / 2017		
	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index	Planifikuar	Faktike	Index
Fatura të shpërndara	1,542,198	1,510,793	98%	1,568,203	1,562,527	100%	102%	103%	102%

Në bazë të shënimeve në tabelë konstatojmë se gjatë vitit 2018 janë përllogaritur dhe shpërndarë 51.734 fatura përkatësisht 3 % më shumë se në vitin 2017. Gjithashtu janë përllogaritur dhe shpërndarë 5.676 përkatësisht ose thënë shkurt është përmbushur në shkallën 100 % Plani i biznesit për vitin 2018.

Paraqitja grafike:



Lidhur me tendencën e faturimit, arkëtimit dhe numrin e konsumatorëve është trajtuar në pjesën hyrëse të raportit. Në tabelën vijuese po paraqesim:

- ✓ Të hyrat e faturuara
- ✓ Të hyrat e arkëtuara
- ✓ Sipas kategorive
- ✓ Normën e arkëtimit
- ✓ Krahasimet me gjendjen faktike 2017 dhe krahasimet me Planin e biznesit 2018

Elementet	Faktike 2017	Janar- dhjetor 2018		Index	
		Planifikuar 2018	Faktike 2018	Faktike/ Plan	2018/ 2017
Të ardhurat e faturuara					
Amvisëria	9,158,442	10,048,330	9,374,253	93%	102%
Bizneset e vogla	1,758,086	1,838,440	1,652,395	90%	94%
Bizneset e mëdha	1,244,526	1,549,875	1,185,311	76%	95%
Institucionet	2,058,566	2,562,419	2,054,130	80%	100%
Total të ardhurat e fat.	14,219,620	15,999,065	14,266,089	89%	100%
Të ardhurat e arkëtuara					
Amvisëria	7,642,687	8,800,324	8,692,345	99%	114%
Bizneset e vogla	1,483,081	1,654,864	1,656,372	100%	112%
Bizneset e mëdha	1,200,890	1,505,640	1,082,659	72%	90%
Institucionet	2,020,517	2,525,854	2,304,873	91%	114%
Total të ardhur.e arkë.	12,347,175	14,486,682	13,736,249	95%	111%
Norma e arkëtimit					
Amvisëria-…..%	83%	88%	93%		
Bizneset e vogla…..%	84%	90%	100%		
Bizneset e mëdha….%	96%	97%	91%		
Institucionet …..%	98%	99%	112%		
Total arkëtimi…..%	87%	91%	96%		

Plani i biznesit është realizuar deri në shkallën 88 %. Ndërkaq është përmbushur në nivel të kënaqshëm vlera e arkëtuar e shërbimeve primare. Tejkalim 11 % në krahasim me vitin 2017 dhe përmbushje 95 % e Planit të biznesit.

Kjo tendencë pozitive shihet edhe nëse i marrim për bazë vlerat relative të të gjithë sektorët.

Paraqitja grafike e strukturës së të ardhurave të faturuara që janë realizuar gjatë vitit 2018



Paraqitja grafike e strukturës së të ardhurave të arkëtuara që janë realizuar në 2017



8.5.1. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU Prishtinë

Elementet	Faktike 2017	Janar-Dhjetor 2018		Index	
		Plani	Faktike	Fakt./Plan 2018	Faktike 2018/17
Të ardhurat e faturuara					
Amvisëria	6,096,976	7,009,019	6,225,734	89%	102%
Bizneset e vogla	1,276,058	1,400,682	1,175,211	84%	92%
Bizneset e mëdha	1,032,585	1,318,832	980,453	74%	95%
Institucionet	1,740,371	2,191,862	1,747,693	80%	100%
Total faturimi	10,145,990	11,920,395	10,129,091	85%	100%
Të ardhurat e arkëtuara					
Amvisëria	5,236,885	6,159,846	6,090,575	99%	116%
Bizneset e vogla	1,091,104	1,270,418	1,210,123	95%	111%
Bizneset e mëdha	998,970	1,281,213	881,555	69%	88%
Institucionet	1,664,791	2,160,613	1,998,996	93%	120%
Total arkëtimi	8,991,750	10,872,090	10,181,248	94%	113%
Te ardhurat tjera	0	0	0	0%	0%
Total të ardhurat	8,991,750	10,872,090	10,181,248	94%	113%

FINAL

Paraqitja grafike e totalit të të ardhurave të faturuara dhe të inkasuar për vitin 2017 dhe 2018, krahasur edhe me Planin e biznesit 2018



Struktura e të ardhurave të faturuara sipas kategorive për vitin 2018 në Prishtinë



Struktura e të ardhurave të arkëtuara sipas kategorive për vitin 2018 në Prishtinë



8.5.2. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU Fushë Kosovë

Elementet	Faktike 2017	Janar-Dhjetor 2018		Index	
		Plani	Faktike	Fakt./Plan 2018	Faktike 2018/17
Të ardhurat e faturuara					
Amvisëria	724,671	683,010	789,187	116%	109%
Bizneset e vogla	102,637	80,747	121,899	151%	119%
Bizneset e mëdha	16,501	23,040	14,459	63%	88%
Institucionet	44,448	41,152	48,241	117%	109%
Total faturimi	888,258	827,949	973,786	118%	110%
Të ardhurat e arkëtuara					
Amvisëria	614,774	600,852	717,962	119%	117%
Bizneset e vogla	98,102	70,937	115,916	163%	118%
Bizneset e mëdha	14,433	22,382	11,610	52%	80%
Institucionet	66,629	40,565	33,066	82%	50%

Total arkëtimi	793,938	734,736	878,554	120%	111%
Te ardhurat tjera	0	0	0	0%	0%
Total të ardhurat	793,938	734,736	878,554	120%	111%

Paraqitja grafike e totalit të të ardhurave të faturuara dhe të inkasuar për vitin 2017 dhe 2018, krahasur edhe me Planin e biznesit 2018



Struktura e të ardhurave të faturuara sipas kategorive për vitin 2017 në Fushë Kosovë



Strkuktura e të ardhurave të arkëtuara sipas kategorive për vitin 2018 në Fushë Kosovë



8.5.3. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Obiliq

Elementet	Faktike 2017	Janar-Dhjetor 2018		Index	
		Plani	Faktike	Fakt./Plan 2018	Faktike 2018/17
Të ardhurat e faturuara					
Amvisëria	579,839	526,854	589,891	112%	102%
Bizneset e vogla	46,042	41,542	48,052	116%	104%
Bizneset e mëdha	16,131	21,208	21,490	101%	133%
Institucionet	29,778	29,839	33,174	111%	111%
Total faturimi	671,790	619,443	692,607	112%	103%
Të ardhurat e arkëtuara					
Amvisëria	444,230	457,905	458,177	100%	103%
Bizneset e vogla	36,874	36,472	37,470	103%	102%
Bizneset e mëdha	14,617	20,597	20,639	100%	141%
Institucionet	27,840	29,409	28,758	98%	103%
Total arkëtimi	523,561	544,383	545,044	100%	104%
Te ardhurat tjera	0	0	0	0%	0%
Total të ardhurat	523,561	544,383	545,044	100%	104%

FINAL

Paraqitja grafike e totalit të të ardhurave të faturuara dhe të inkasuar për vitin 2018 dhe 2017, krahasur edhe me Planin e biznesit 2018



Struktura e të ardhurave të faturuara sipas kategorive për vitin 2018 në Obiliq



Struktura e të ardhurave të arkëtuara sipas kategorive për vitin 2018 në Obiliq



8.5.4. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Graqanicë

Elementet	Faktike 2017	Janar-Dhjetor 2018		Index	
		Plani	Faktike	Fakt./Plan 2018	Faktike 2018/17
Të ardhurat e faturuara					
Amvisëria	239,453	258,795	229,259	89%	96%
Bizneset e vogla	40,881	51,042	35,577	70%	87%
Bizneset e mëdha	78,871	86,992	70,702	81%	90%
Institucionet	23,868	37,869	20,665	55%	87%
Total faturimi	383,073	434,697	356,203	82%	93%
Të ardhurat e arkëtuara					
Amvisëria	289,360	225,843	285,402	126%	99%
Bizneset e vogla	33,172	44,854	36,340	81%	110%
Bizneset e mëdha	84,201	84,510	80,650	95%	96%

Institucionet	66,649	37,328	27,722	74%	42%
Total arkëtimi	473,382	392,536	430,113	110%	91%
Te ardhurat tjera	0	0	0	0%	0%
Total të ardhurat	473,382	392,536	430,113	110%	91%

Paraqitja grafike e totalit të të ardhurave të faturuara dhe të inkasuar për vitin 2017 dhe 2018, krahasur edhe me Planin e biznesit 2018



Strkuktura e të ardhurave të faturura sipas kategorive për vitin 2018 në Graqanicë



Strkuktura e të ardhurave të arkëtuara sipas kategorive për vitin 2018 në Graqanicë



8.5.5. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Shtime

Elementet	Faktike 2017	Janar-Dhjetor 2018		Index	
		Plani	Faktike	Fakt./Plan 2018	Faktike 2018/17
Të ardhurat e faturuara					
Amvisëria	219,397	219,016	199,615	91%	91%
Bizneset e vogla	32,591	33,752	28,589	85%	88%
Bizneset e mëdha	1,042	1,028	1,201	117%	115%
Institucionet	36,318	50,773	43,755	86%	120%
Total faturimi	289,348	304,569	273,161	90%	94%
Të ardhurat e arkëtuara					
Amvisëria	142,426	190,281	135,038	71%	95%
Bizneset e vogla	25,450	29,624	22,753	77%	89%
Bizneset e mëdha	582	998	563	56%	97%

Institucionet	38,340	50,039	63,170	126%	165%
Total arkëtimi	206,797	270,943	221,523	82%	107%
Te ardhurat tjera	0	0	0	0%	0%
Total të ardhurat	206,797	270,943	221,523	82%	107%

Paraqitja grafike e totalit të të ardhurave të faturuara dhe të inkasuar për vitin 2017 dhe 2018, krahasur edhe me Planin e biznesit 2018.



Strkuktura e të ardhurave të faturura sipas kategorive për vitin 2018 në Shtime



Strkuktura e të ardhurave të arkëtuara sipas kategorive për vitin 2018 në Shtime



8.5.6. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Lipjan

Elementet	Faktike 2017	Janar-Dhjetor 2018		Index	
		Plani	Faktike	Fakt./Plan 2018	Faktike 2018/17
Të ardhurat e faturuara					
Amvisëria	441,013	400,871	453,647	113%	103%
Bizneset e vogla	82,225	62,425	83,762	134%	102%
Bizneset e mëdha	67,274	67,323	69,193	103%	103%
Institucionet	70,366	61,255	67,080	110%	95%
Total faturimi	660,877	591,875	673,681	114%	102%
Të ardhurat e arkëtuara					
Amvisëria	300,002	349,559	335,120	96%	112%
Bizneset e vogla	60,824	54,812	78,761	144%	129%
Bizneset e mëdha	63,880	65,388	65,167	100%	102%
Institucionet	55,781	60,375	70,792	117%	127%
Total arkëtimi	480,487	530,133	549,840	104%	114%
Te ardhurat tjera	0	0	0	0%	0%
Total të ardhurat	480,487	530,133	549,840	104%	114%

FINAL

Paraqitja grafike e totalit të të ardhurave të faturuara dhe të inkasuar për vitin 2017 dhe 2018, krahasur edhe me Planin e biznesit 2018



Struktura e të ardhurave të faturuara sipas kategorive për vitin 2018 në Lipjan



Struktura e të ardhurave të arkëtuara sipas kategorive për vitin 2018 në Lipjan



8.5.7. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Podujevë

Elementet	Faktike 2017	Janar-Dhjetor 2018		Index	
		Plani	Faktike	Fakt./Plan 2018	Faktike 2018/17
Të ardhurat e faturuara					
Amvisëria	583,354	666,024	589,915	89%	101%
Bizneset e vogla	100,770	106,073	86,228	81%	86%
Bizneset e mëdha	21,040	21,010	22,250	106%	106%
Institucionet	55,223	91,119	49,594	54%	90%
Total faturimi	760,387	884,227	747,987	85%	98%
Të ardhurat e arkëtuara					
Amvisëria	416,506	571,731	438,723	77%	105%
Bizneset e vogla	84,851	93,159	82,053	88%	97%
Bizneset e mëdha	10,803	20,409	17,325	85%	160%
Institucionet	52,681	89,816	52,461	58%	100%

Total arkëtimi	564,840	775,115	590,562	76%	105%
Te ardhurat tjera	0	0	0	0%	0%
Total të ardhurat	564,840	775,115	590,562	76%	105%

Paraqitja grafike e totalit të të ardhurave të faturuara dhe të inkasuar për vitin 2017 dhe 2018, krahasur edhe me Planin e biznesit 2018



Strkuktura e të ardhurave të faturura sipas kategorive për vitin 2018 në Podujevë



Strkuktura e të ardhurave të arkëtuara sipas kategorive për vitin 2018 në Podujevë



8.5.8. Të hyrat e faturuara, të hyrat e arkëtuara dhe norma e arkëtimit në NJOU- Drenas

Elementet	Faktike 2017	Janar-Dhjetor 2018		Index	
		Plani	Faktike	Fakt./Plan 2018	Faktike 2018/17
Të ardhurat e faturuara					
Amvisëria	273,395	284,740	297,004	104%	109%
Bizneset e vogla	77,227	62,177	73,076	118%	95%
Bizneset e mëdha	11,082	10,443	5,563	53%	50%
Institucionet	58,194	58,550	43,929	75%	75%
Total faturimi	419,897	415,911	419,573	101%	100%
Të ardhurat e arkëtuara					
Amvisëria	198,505	244,308	231,348	95%	117%
Bizneset e vogla	52,704	54,589	72,958	134%	138%
Bizneset e mëdha	13,404	10,142	5,149	51%	38%
Institucionet	47,806	57,707	29,908	52%	63%
Total arkëtimi	312,419	366,746	339,364	93%	109%

FINAL

Te ardhurat tjera	0	0	0	0%	0%
Total të ardhurat	312,419	366,746	339,364	93%	109%

Paraqitja grafike e totalit të të ardhurave të faturuara dhe të inkasuar për vitin 2017 dhe 2018, krahasur edhe me Planin e biznesit 2018.



Struktura e të ardhurave të faturuara sipas kategorive për vitin 2018 në Drenas



Strkuktura e të ardhurave të arkëtuara sipas kategorive për vitin 2018 në Drenas



8.6. Raporti i departamentit të kontabilitetit dhe thesarit

Departamenti, kujdeset për evidentimin, ruajtjen dhe raportimin e te gjitha transaksioneve financiare brenda ndërmarrjes. Procesimi i te gjitha dokumenteve financiare bëhet në mënyrë kronologjike në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Departamenti kryen këto detyra:

- ✓ Evidencën kontabël
- ✓ Pagesat e furnitorëve
- ✓ Regjistrin e asketeve
- ✓ Regjistrin e materialeve (depo)
- ✓ Kalkulimin dhe pagesën e pagave
- ✓ Tatimet dhe taksat
- ✓ Raportimin financiar interno dhe ekstrën

FINAL

Treguesit e performancës për vitin 2018

Emërtimi	Faktike 2017	Janar-Dhjetor 2018		Index	
		Plani 2018	Faktike 2018	2018/ 2017	Faktike/ Plani
Uji i prodhuar	52,087,383	53,823,000	54,569,918	105%	101%
Uji i faturuar	22,324,369	25,478,621	21,841,206	98%	86%
Konsumatorët e regjistruar	141,969	146,343	146,569	103%	100%
Numri i faturave të lëshuara	128,399	132,803	132,913	104%	100%
Numri i konsumatorëve qe faturohen sipas leximit te ujëmatësve	125,006	130,147	129,279	103%	99%
Uji i faturuar per konsumatorët me ujëmatës	21,543,898	24,459,477	21,131,711	98%	86%
Faturimi	14,219,620	15,999,477	14,140,101	99%	88%
Arkëtimi	12,347,175	14,486,682	13,736,249	111%	95%
Të hyra të tjera operative	187,395	314,638	165,934	89%	53%
Shpenzimet operative pa amortizim	8,793,959	10,344,753	10,658,924	121%	103%
Të hyrat jo operative	1,562,369	1,177,568	2,149,736	138%	183%
Investimet kapitale	41,134,520	1,324,000	12,507,232	30%	945%
Llogaritë e arktueshme	55,698,564	57,525,997	58,095,783	104%	101%
Numri i punëtorëve	543	550	560	103%	102%
Përqindja e faturimit	43%	47%	40%	93%	85%
Përqindja e konsumimit te matur	97%	96%	97%	100%	101%
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës	97%	98%	97%	100%	99%
Shkalla e inkasimit	87%	91%	97%	112%	107%
Shkalla e inkasimit (% amv)	84%	80%	83%	99%	104%
Shkalla e inkasimit (% bis)	96%	86%	84%	88%	98%
Shkalla e inkasimit (% bis) te mëdha	108%	96%	96%	90%	100%
Shkalla e inkasimit (% inst)	100%	98%	98%	98%	100%
Norma e mbulesës se punës	1.43	1.43	1.30	92%	91%
Shpenzimet Operative per konsumatorë	68	78	80	117%	103%

FINAL

Shpenzimet e ujit të blerë janë më të mëdha se në vitin 2017 për shkak se fabrika në Shkabaj gjatë vitit 2017 nuk ka pasë vitin e plotë.

Shpenzimet e energjisë elektrike janë më të vogla edhe në krahasim me vitin paraprak dhe Planin e biznesit.

Mirëpo ajo që është shqetësuese është kontabilizimi i përnjëhershëm i taksës për ujin e nxjerrë dhe të përpunuar të cilat shpenzime nuk janë kontabilizuar viteve më përpara në vlerë prej 365.954 €.

Gjithashtu edhe ndërrimi i mënyrës së njohjes së shpenzimeve për pagesën e kamatës dhe interesit në vlerë prej 486.637 € , ka ndërruar strukturën. Këto shpenzime viteve të kaluara i janë bashkëngjitur vlerës së aseteve në ndërtim (fabrikës në Shkabaj).

Shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes

Shpenzimet ne total	Faktike 2017	Janar- dhjetor 2018		Indexi	
		Plani 2018	Faktike 2018	Index 2018/2017	Index 2018/Plani
Vlera furnizuese e materialit	425,800	657,650	642,196	151%	98%
Shpenzimet e energjisë	2,472,201	2,900,647	2,312,212	94%	80%
Shpenzimet e karburanteve	105,418	156,000	117,861	112%	76%
Shpenzimet e personelit	5,036,900	5,040,287	5,137,160	102%	102%
Shpenzimet material	501,269	699,212	739,460	148%	106%
Shërbimet e jashtme kontraktuese	569,362	752,781	703,808	124%	93%
Shpenzimet e rekreacionit, sportit, kulturës, ndihmave solidare	5,798	0	7,942	137%	#DIV/0!
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	119,429	90,077	117,000	98%	130%
Shpenzime tjera	23,244	48,100	876,719	3772%	1823%
Totali i shpenzimet operative	**9,259,420**	**10,344,753**	**10,654,358**	**115%**	**103%**

FINAL

Paraqitja grafike e kategorive te caktuara te këtyre shpenzimeve ka këtë pamje:



8.7. Raporti i departamentit të prokurimit

Qëllimi raportit është prezantimi i punëve të Departamentit të Prokurimit në kuadër të ndërmarrjes gjatë vitit 2018. Angazhimi, përgjithësisht ka qenë i koncentruar në pranimin e kërkesave nga departamentet dhe njësitë të ndryshme në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik.

Tabelat ne vazhdim japin te dhëna mbi kërkesat sipas planit të prokurimit dhe kërkesat jashtë planit të prokurimit, për vitin 2018 si dhe një krahasim me vitin paraprak 2017. Duke krahasuar te dhënat e viteve përkatëse mund te vërehet niveli i performances se departamenteve dhe/njësive të KRU PRISHTINA sh.a.

Sa i përket performances së Departamentit të Prokurimit, kësaj radhe nuk do japim shumë të dhëna, përveç faktit se departamenti ka realizuar detyrat ne shkallen 100%. Kjo është lehte e matshme, gjate analizimit të raporteve paraprake nga te cilat mund te shihet se detyrat janë kryer pa vonesa, duke u procesuar te gjitha kërkesat në tërësi, pa përjashtim.

Përshkrimi i aktiviteteve: Të dhënat mbi kërkesat e tërësishme gjatë vitit 2018

Sipas planit/ jashtë Planit	Përshkrimi	Numri i kërkesave	Shprehur ne %	Sipas vlerës (€)	Shprehur ne %	Planifikimi/ Realizimi (€)	Tejkalim nga plani I realizimit sipas vlerave te parashikuara
SIPAS PLANIT TE PROKURIMIT 2018	**Kërkesa te planifikuara te dorëzuara (sipas vlerave te parashikuara)**	**76**	**100**	**3,642,350.00**	**100**	**3,642,350.00**	
	Kërkesa te planifikuara te dorëzuara dhe te përfunduara & rialokuara	*55*	*72.37*	*3,161,300.00*	*86.79*	3,864,270.00	*106%*
	Kërkesa te planifikuara te dorëzuara e te dështuara nga mos-dorëzimi I ofertave	*5*	*6.58*	*121,300.00*	*3.33*		
	Kërkesa te planifikuara te dorëzuara & stopuar	*4*	*5.26*	*175,000.00*	*4.8*		
	Kërkesa te planifikuara te pa-dorëzuara(sipas vlerave te parashikuara)	*12*	*15.79*	*184,750.00*	*5.07*		
JASHT PLANIT TE PROKURIMIT 2018	*KERKESA JASHTE PLANIT TE REALIZUARA_ V.2018*	*18*	*23.68*	*702,970.00*	*19.3*		
	KERKESA JASHTE PLANIT TE DESHTUARA_V.2018	*1*	*1.32*	*70,000.00*	*1.92*		

Nga tabela mund te shihet se vlera e tërësishme e kërkesave te planifikuara gjate vitit 2018 ka qene 3,642,350.00 €, nga te cilat 3,161,300.00 € (86.79%)jane realizuar, 121,300.00 € (3.33%) kane dështuar ne mungese te ofertave te dorëzuara, 175,000.00 € (4.8%) janë ndërprere/stopuar, ndërsa për pjesën tjetër prej 184,750.00 € (5.07%) nuk ka pas kërkesa te dorëzuara.

Përveç vlerave te parashikuara, gjate vitit 2018 kemi pas edhe rreth 772,970.00 € (19.30%), si kërkesa te paparashikuara.

FINAL

Edhe pse ne shikim te pare, rritja e vlerës se kërkesave jashtë planit, duket si trend negativ, rritja e ketyre kerkesav mund te cilesohet si sukses, pasi qe kompania ka arritur te "tërheqë" dhe procedojë aktivitetet me mjete donacion, siç janë mjetet prej 470,000.00 € për projektin Shkabaj –Fushe Kosove apo edhe ato per Automjete Operative, me fonde donacion nga KfË, ne vlere prej mbi 160,000.00 €.

Kur behet rekapitullimi i situatës, rezulton se shkalla e aktiviteteve te realizuara, ne raport me ato te planifikuara, gjithnjë sipas vlerave te parashikuara, te ketë tejkalim prej 6%.

Të dhënat statistikore për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017

KËRKESAT E DOREZUARA NE PROKURIM SIPAS VLERAVE TE PARASHIKUARA	**Viti 2017**	**2018**	**Performanca 2018/2017**
1.1 Numri i kërkesave te planifikuara	**64 kërkesa**	**76 kërkesa**	**18.75 % rritje**
1.2 Numri i kërkesave te dorëzuara sipas planit	38 kërkesa (59.37 %)	61kerkesa (80.27%)	20.90 % rritje
1.3 Numri i kërkesave te dorëzuara jashtë planit	17 kërkesa (26.56 %)	19 kërkesa (25 %)	1.56 % rënie
1.4 Numri i kërkesave te tërësishme	**55 kërkesa (85.94 %)**	**80 kërkesa (105.20 %)**	**19.33 % rritje**
1.5 Vlera e parashikuar sipas planit	3,023,500.00 €	3,642,350.00	20.47 % rritje
1.6 Vlera e parashikuar jashtë planit	87,723.00 €	772,970.00 €	88.65 % rritje***
1.7 Vlera e kërkesave te dorëzuara ne tërësi, sipas vlerave te parashikuara	**2,094,748.35 €**	**4,415,320.00 €**	**110.78 % rritje**

Siç shihet nga tabelat 2, numri i planifikuar i kërkesave gjatë vitit 2018 ka qenë për 18.75 % më i lartë se sa i atyre të planifikuara në vitin 2017 (pika 1.1).

Ne proporcion te njëjte ka qene edhe numri i kërkesave të dorëzuara sipas planit te prokurimit, 20.90 % me i larte se sa ne vitin 2017 (pika 1.2).

Gjatë vitit 2018, kërkesat e paplanifikuara, shprehur ne përqindje sipas sasisë se tyre, kanë qenë në shkallë më të ulët se sa ato të pa-planifikuara gjatë vitit 2017, pra 1.56 me e ulet (pika 1.3).

Sa u përket vlerave financiare, kërkesat jashtë planit te prokurimit gjate vitit 2018 kane treguar rritje drastike, krejt kjo si rrjedhoje e mjeteve donacion, pra mjetet qe u potencuan me larte (pika 1.6).

Numri i tërësishëm i kërkesave ne v.2018 ka treguar trend pozitiv, pasi qe ky numër ne këtë vit tejkalon vitin 2017 me 19.33 % (pika 1.4)

FINAL

Njoftime për kontratë

NJOFTIME PËR KONTRATË	Viti 2017	Viti 2018	Performanca 2018/2017
Numri i njoftimeve për kontrate	43	77	79 % rritje

Numri i njoftimeve për kontratë (publikimeve për tenderë), ne mënyrë proporcionale, ka pësuar rritje, nga 43 ne v.2017 ne 77 ne v.2018 (79 % rritje).

Njoftime për dhënie të kontratës-

NJOFTIME PËR DHËNIE TË KONTRATËS	Viti 2017	Viti 2018	Performanca 2018/2017
Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës	50	55	10 % rritje

Nga paraqitja tabelore e mëposhtme shihet se, njoftimet për dhënie te kontratave kanë pësuar rritje. Konkretisht, këto njoftime janë rritur nga 50 sosh, sa kane qene ne vitin 2017 ne 55 ne ato te vitit 2018 (10 % rritje).

Kontrata të nënshkruara dhe vlerat e tyre

VLERA E KONTRATAVE TE NENSHKRUARA	Viti 2017	Viti 2018	Performanca 2018/2017
4.1 Numri i kontratave te nenshkruara	57	71	24.75 % rritje
4.2 Vlera e Kontratave te nenshkruara	1,830.708.86 €	2,188,404.00 €	19.54 % rritje

Proporcionalisht me njoftimet për dhënie të kontratës, edhe numri i kontratave të nënshkruara ka shënuar rritje. Numri i tyre ne vitin 2018, krahasuar me ate 2017, është rritur për 24.75 %, përderisa për nga vlera ka patur rritje në shkallën prej 19.54 % (pikat 4.1 & 4.2).

Numri i kërkesave të pa-dorëzuara gjatë viti 2018, ka qenë me i ulet për 13 kërkesa, krahasuar me vitin 2017 (40% zvogëlim).

FINAL

Pezullimi i aktiviteteve të prokurimit me vendim të OSHP-së

PEZULLIM TË AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT ME VENDIM TE OSHP	Viti 2017	Viti 2018
Numri i ankesa ne OSHP	0	7
Numri I ankesave te cilësuara si te pa-bazuara	0	6
Numri i aktiviteteve te kthyera ne ri-vlerësim	0	1

Gjatë vitit 2018, per dallim nga v.2017, ka patur shume ankesa te dorëzuara ne OSHP. Nga gjithsejt 7 ankesa te dorëzuara ne Prokurim, 6 ankesa janë hedhe poshtë nga OSHP si te pabazuara, ndërsa 1 ankese është cilësuar si pjesërisht e bazuar dhe aktiviteti eshet kthyer ne ri-vlerësim. E njëjta me vone eshet anuluar dhe tani jemi ne fazën e ri-tenderit te këtij aktiviteti.

Raporti i drejtorisë Teknike

Ne kuadër te drejtorisë teknike deri ne fund te 2018, kane qene 5 departamente duke përfshirë te gjitha aktivitetet nga Prodhimit/trajtimi, pastaj Operimi dhe Mirëmbajtja, Kualiteti i Ujit dhe Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim si dhe Departamenti i Mirëmbajtjes dhe trajtimit te ujërave të zeza . Ne fund te 2018 është aprovuar nga BD edhe departamenti për luftimin e Humbjeve.

Gjate vitit 2018 kompania, respektivisht drejtoria teknike ka arritur qe se bashku me stafin e saje inxhinierik me te gjitha kapacitetet tjera teknike te realizoj dhe mbikëqyrë shume projekte te ndjeshme dhe projekte vitale ne te njëjtën kohe. Stafi inxhinierik i kompanisë përveç projektimeve qe mbulon te gjitha nevojat e kompanisë, ne te njëjtën kohe ka udhëheq me grupet e implementimit per projekte te ndryshme infrastrukturore. Plotësimi i vendeve vakante me staf adekuat do te ndikonte ne përmirësimin e shërbimeve respektivisht ne ngritjen e performances se kompanisë duke arritur caqet dhe misionin e vizionin e caktuar.

Fale bashkëpunimit me Agjensionin për Zhvillim nga Hungaria është fituar donacion ne vlere 30,000.00 Euro, ne instalimin e grirësit te mbeturinave për Impiantin ne Harilac, pajisje e montuar ne vitin vijues 2019

Ne te gjitha zonat ku janë ndërruar rrjetat e furnizimit me uje ne baze te monitorimit kemi ulje te humbjeve teknike dhe këto humbje tani ne këto zona nuk kalojnë vlerën mbi 10 %. Vlen te përmendet qe sado qe është stafi i vogël ne shërbimin e detektimit te rrjedhjeve ka vazhduar trendi i uljes se humbjeve për DMA-t qe janë ne monitorim.

Ne bashkëpunim me zyrën Zvicerane kane filluar implementimin edhe te 4 DMA zonave te reja ne Lipjan, Prishtine, Drenas dhe Podujeve.

Drejtoria teknike ne kuadër te KRU Prishtina ka edhe laboratorët e akredituara nga DAK, te cilat monitorojnë 24 ore ujin.

Duhet te theksohet se te gjitha këto veprat te përuruara gjate vitit 2017 ne vazhdimësie kane operuar me stafin e kompanisë dhe vazhdojnë te operohen ne tërësi nga stafi profesional i KRU Prishtina, duke përgatitur edhe raporte dhe strategji për avancimin e infrastrukturës, monitorimin e objekteve nga distanca etj.

FINAL

Gjate vitit 2018 jane mbajtur trajnime dhe avansime te stafit ne aspektin profesional duke qene pjese e ekipeve pjesëmarrëse ne trajnim, apo ne nivel trajneri.

8.8. Raporti i departamentit të planifikimit dhe zhvillimit

Departamenti i planifikimit dhe zhvillimit në mënyrë figurative paraqet trurin e ndërmarrjes. Konstatimi vjen nga fakti se zgjidhjet ideore të të gjitha proceseve fillojnë, përkatësisht mbështeten drejtpërdrejt nga personeli specializuar i Departamentit. Departamenti përveç operimeve ditore teknike merret edhe me analizë analitike të të gjithë treguesve teknik dhe financiar të përcaktuar nga Autoriteti Rregullator i Ujit.

Aplikimi dhe Shqyrtimi I lëndëve për vitin 2018 sipas evidencës se lendeve te proceduara ne DPZH					
Nr.	Viti 2018	Te prcesuara	Te refuzuara	Arsyetimi	Gjithsej Aplikime
1	Informacione për infrastrukturë	108	0	-	108
2	Kushte Teknike	393	12	Borxhe të Pashlyera	405
3	Kyqje Kolektive	58	9	Mungesë Dokumentacioni	67
4	Kyqje Individuale	124	7	Mungesë Dokumentacioni	131
5	Legalizimi Individual (Konsumatorë)	418	0	-	418
6	Legalizimi Kolektiv (Investitor- Për Ndërtesa)	41	0	-	41
	Gjithësej	**1142**	**28**	**-**	**1170**

8.8.1. Zyra e Sistemit informativ gjeografik (GIS) dhe gjeodezisë

Shërbimi i i GIS dhe gjeodezisë në vazhdimësi gjatë vitit 2018 ka kryer të gjitha punë të cilat kanë qenë te drejtuara në departament si dhe ka qenë në shërbim të të gjitha departamentet të cilat kane kërkuar të dhëna si dhe dhe palët e treta në të njëjtën kohë.

Zyra e gjeodezisë dhe GIS-it për organizimin e punëve në lëmin e autorizimeve dhe kompetencave në ndërmarrje e përdorë softuerin ARCGIS me anë të cilit është krijuar një infrastrukturë themelore për shfrytëzimin e këtij sistemi profesional.

Zyra e gjeodezisë dhe GIS-it ka bërë azhurnimin e të gjitha të dhënave në platformën e ArcGis-it në baza ditore, të dhëna keto të rëndesishme per zhvillimin dhe vendimmarrje për KRU"Prishtina"

FINAL

Në kuadër të punëve dhe veprimeve operative janë ndërmarrë edhe këto aktivitete:

- Skanimi i planeve ekzistuese me të dhëna të infrastrukturës se rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit, përpunimi , gjeoreferencuara në sistemin KosovaRef01
- Pranimi dhe procesimi i të dhënave digjitale për nevoja të azhurnimit të bazës së të dhënave në GIS
- Rregullimi i treguesve dhe ujëmatëseve të ri dhe të vjetër në Lagjen Dodona, harmonizimi i data bazave (e reja me të vjetrën).
- Adresim i problemit te Gdi Shkup dhe IT e KRU Prishtina për problemet me GISserver dhe Backup Server(nga data 20.03.18-28.03.18)-shkëmbim email-ash, deri te zgjidhja e problemit etj.
- Futja e te dhënave te legalizimeve te orëve individuale ne sistemin e GIS-it
- Pranimi, skenimi, indeksimi dhe shpërndarja e kërkesave të drejtuara në DPZH.
- Azhurnimi (Vizatimi) i rrjetit, pusetave zonale degëzuese dhe elementeve te tjerë për territorin e Prishtinës.
- Ne kuadër te këtij shërbimi personeli I angazhuar realizon matjet ne terren kontrollet dhe mbikëqyrjen e projekteve, azhurnimet e matjeve dhe dokumentacioneve te dorezuara. Gjithashtu ofron shërbime edhe për departamentet tjera ne kuadër te kompanisë. Pjese e detajuar e angazhimeve gjendet ne raportet mujore për departamente.

Paraqitja tabelare e monitorimit të nivelit të ujit në liqenin e Badocit për vitin 2018		
Kuota mesatare	649.80	Kaperderdhje
Kuota maksimale	648.29	Niveli maksimal
Kuota minimale	645.51	Niveli minimal

FINAL

Digramit i monitorimit të nivelit të ujit në liqenin e Badocit për vitin 2018



8.8.2.Shërbimi i planifikimit

Shërbimi i projektimit dhe planifikimit është marrë me veprimtari nga më të ndryshmet:

- Analizimi i kërkesave për kushte teknike, kërkesave për lidhje uji, dhe përgatitja e pëlqimeve.
- Inspektime dhe matjet e e nevojshme për lëshimin e pëlqimeve për lidhje në sistemin e ujësjellësit
- Hartimin e projekteve për vitin 2018 te parapara me planin e prokurimit.
- Angazhime për kompletimin e dokumentacionit për Leje Ujore.
- Përpunimi i materialit për zonat mbrojtëse te dy liqeneve Batllava dhe Badovcit.
- Mbikëqyrje dhe menaxhim kontratash ne varësi te vendimeve te KE duke filluar nga projektimi, konsultat, mbikëqyrja dhe zgjedhjet tjera teknike

8.8.3.Zyra për Planin e biznesit, monitorim të performancës dhe procesin tarifor

Për qëllime të analizimit të situatës dhe ndërmarrjes së veprimeve të duhura në kohë dhe cilësi në kuadër të Departamentit kryhen edhe këto raporte periodike;

- ✓ Përgatitja e Planit të biznesit për periudhën 2019-2021 (për vitin në vijin dhe 2 vitet pasuese)
- ✓ Rishikimi i Planit të biznesit të periudhës përkatëse
- ✓ Përgatitja e aplikacionit për modifikimet e nevojshme për Tarifën e shërbimit për vitin 2019
- ✓ Monitorimi i përmbushjeve të objektivave të përcaktuara me Planin e biznesit (mujore, tremujore, gjashtë mujore, nëntëmujore dhe vjetor)
- ✓ Monitorimi përmbushjes së objektivave te Aplikacionit tarifor (në baza tremujore, gjashtë mujore, nëntëmujore dhe vjetor)
- ✓ Krahasimi i vlerave financiare të ndërmarrjes me ndërmarrjet tjera të ujësjellës kanalizimeve dhe me mesataren e sektorit të ujit në Kosovë
- ✓ Raportet për trendin e faturimit të shërbimeve bazë sipas Njësive operative të ujit
- ✓ Përcjellja dhe raportimi periodik për trendin e shpenzimeve të operimit
- ✓ Përgatitja, analizimi dhe komentimi i Raportit vjetor gjithëpërfshirës

Në kuadër të zyrës kryhen edhe veprime të ndryshme sipas nevojave dhe të pa specifikuara. Konsultime të ndryshme profesionale në trajtimin e problemeve ekonomike-financiare.

8.9. Raporti i departamentit të prodhimit

Departamenti i prodhimit, përfaqëson „boshtin kurrizor“ të ndërmarrjes. Të gjitha veprimet fillestare për një punë të suksesshme me qëllim të përmbushjes së „misionit“ dhe „vizionit“ të ndërmarrjes kanë bazën fillestare. Kjo do të thotë të krijoj më besueshmëri dhe respekt, të jemi mirë të krahasueshëm me ndërmarrjet tjera të ujësjellës kanalizimeve.

Në Departamentin e Prodhimit kemi vazhduar me realizimin e planifikimit të prodhimit për muajit dhe vitin respektiv. Prodhimi vjetor është afërsisht me planifikimin vjetor. Uji primar në Liqejt akumulues ka arritë të ketë një kualitet më të mirë ashtu që kemi mundësi që të punojmë me kapacitete optimale. Në FPU Shkabaj jemi ballafaquar me ngecje të herë pas hershëm për shkak të ngritjes së turbiditetit në ujin e kanalit si dhe prezencës se algjeve sidomos ne sezonin e pranverës, gjithashtu edhe për shkak të mungesës së ujit në kanal si shkak i ujitjes nga bujqit e fushave dhe të mbjellave të tyre.

Edhe nëpër Njësi Operative në Komuna tjera kemi një trajtim bazuar në kapacitete optimale dhe përshtatur nevojave të kërkesës së prodhimit të ujit të pijes, ani pse fundi i vitit 2018 dhe fillimi i vitit 2019 na gjene me nje sezon relativisht te thate.

Prodhimi për vitin 2018 sipas matjeve me ultrasonik duke zbritur shpëlarjen e tubacioneve magjistrale, nëse vendosim si prodhim sasinë e ujit qe janë shpërlarë tubacione si kërkesë ligjore e operimit dhe mirëmbajtës prodhimi ne total per vitin 2018 kap vlerën prej: V= 52,255,557 m^3

Prodhimi për periudhën janar- dhjetor të vitit 2018

Viti-muaji	TOTALI			
2018	**TOTALI I UJIT TË DISTRIB. ~m³/muaj~**	**TOTALI I UJIT TË DISTRIB ~l/s**	**E PLANIFIKUAR ~m3/muaj~**	**Përqindja e realizuar**
Janar	4,643,495	1,734	4,491,677	103.38 %
Shkurt	3,928,950	1,624	4,056,998	96.84 %
Mars	4,269,012	1,594	4,491,677	95.04 %
Prill	4,374,311	1,687	4,346,784	100.6 %
Maj	4,546,923	1,698	4,491,677	101.23%
Qershor	4,285,637	1,653	4,346,784	98.59%
Korrik	4,390,818	1,639	4,491,677	97.75%
Gusht	4,597,535	1,717	4,491,677	102.36%
Shtator	4,414,273	1,703	4,346,784	101.55%
Tetore	4,089,285	1,527	4,491,677	91.04%
Nentore	4,047,833	1,562	4,346,784	93.12%
Dhjetore	4,290,398	1,602	4,491,677	95.52 %
Totali 2018	51,999,576	1,649	52,885,872	98.32%

Aneks: Tabelë krahasuese me planin dhe periudhën e njëjte të vitit paraprak (janar-dhjetore 2017)

Viti-muaji	TOTALI			
2017	**TOTALI I UJIT TË DISTRIB. ~m³/muaj~**	**TOTALI I UJIT TË DISTRIB ~l/s**	**E PLANIFIKUAR ~m3/muaj~**	**Përqindja e realizuar**
Janar	4,035,008	1506.50	3,714,940.80	108.62%
Shkurt	3,740,319	1546.10	3,355,430.40	111.47%
Mars	3,994,768	1491.48	3,714,940.80	107.53%
Prill	4,083,556	1575.45	4,424,544.00	92.29%
Maj	4,249,862	1586.72	4,572,028.80	92.95%

FINAL

Qershor	4,509,537	1739.79	4,424,544.00	101.92%
Korrik	4,858,960	1814.13	4,572,028.80	106.28%
Gusht	4,902,967	1830.56	4,572,028.80	107.24%
Shtatore	4,484,010	1729.94	4,424,544.00	101.34%
Tetor	4,511,158	1684.27	4,572,028.80	98.67%
Nëntor	4,376,009	1688.28	4,424,544.00	98.90%
Dhjetore	4,341,229	1620.83	4,572,028.80	94.95%
Totali 2017	52,087,383	1,651	51,343,632.00	101.85%

8.10. Raporti i departamentit të mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit

Departamenti me shërbimet e veta, bënë mirëmbajtjen e të gjitha objekteve dhe pajisjeve të KRU "Prishtina" sh.a. duke u përgjigjur për gatishmërinë e tyre teknike dhe funksionale. Bënë sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në Zonën e shërbimeve te të gjitha defektet , avarit dhe pengesat e tjera që paraqiten. Intervenimet e tilla organizohen sa më shpejtë dhe sa me më pak shpenzime duke u mbështetur në radhë të parë në mjetet e KRU-së dhe materialin te cilën e ka ne dispozicion. Ne kuadër te këtij Departamenti Operojnë këto shërbime :

- Shërbimi i rrjetit te ujit,
- Shërbimi i ujëmatëseve,
- Shërbimi i makinerisë,
- Shërbimi i elektrikes,
- Shërbimi i elektronikës
- Shërbimi i detektimit te rrjedhjeve dhe
- Objektet-rezervarët në qytet

8.10.1. Shërbimi i rrjetit të Ujit

Ky shërbim gjate vitit 2018 ka intervenua ne **1862** raste te ndryshme kryesisht ne rrjeta me profile te vogla.

Defektet e shumta ne gypat ku pa tjetër duhet te intervenohet ne ndërrimin e tyre si pasoje e materialit te dobët:

- Gypi Ø90 PE ne Vranidoll

- Gypi Ø110PE ne Sinidoll

- Gypi Ø225 dhe Ø160 ne Rr. "Bajram Bahtiri "

- Gypi Ø110 PVC ne Dobrevë

FINAL

- Gypi Ø250 PE ne Fushë Kosovë.

Ky shërbim ketë vite është ballafaquar me problemin e mungesës se stafit sidomos për pjesën periferike te Prishtinës dhe F. Kosovës, ku vetëm me një ekip operohet ne ket pjesë e qe është e pa mundur te kryhen te gjitha rastet e defekteve me kohë. Një zgjidhje kishte me qen nëse ne Fushe Kosovë formohet një ekip i veçante i mirëmbajtjes.

Departamenti i Mirëmbajtjes, ka nevoje te freskohet me punëtorë te ri, meqë një pjese është e shtyre ne moshe si dhe ne gjendje te vështirë shëndetësore.

Ka nevoje te avancohet ky shërbim përveç ekipit te ndërrimit te dytë, medoemos duhet te shtohet edhe një ekip kujdestarie gjate natës.

8.10.2. Shërbimi e rrjetit te kanalizimit

Përveç rasteve të prezantuara në në tabelën paraprake që janë gjithsej **3.081**, të gjitha janë kryer në kohë. Në krahasim me vitin 2016 kemi një rënie të vogël të intervenimeve. Janë bërë pastrime të shumta të pusetave të cilat gjatë reshjeve të shirave nga pakujdesia e qytetarëve janë mbushur me mbeturina .

Problem në ketë shërbim paraqet sistemi i kombinuar (miks) i rrjetit te ujërave të zeza me sistemin e ujërave atmosferike. Si rrjedhojë na paraqiten probleme gjatë reshjeve atmosferike, gjithashtu mungesa e kapakëve te pusetave nga dëmtimet e ndryshme si dhe vjedhja e tyre.

8.10.3.Shërbimi i ujëmatësve

Është intervenuar ne riparimin e ujëmatësve të ndryshëm, gjithsej **1820** raste, ne ndërrimin e valvuleve para dhe pas ujëmatësve, pastrimin apo edhe ndërrimin e xhamave te ujëmatësit, si dhe ndërrimin e ujëmatësve. Ketë vite janë vendose 503 Ujëmatës "smart" ne Zonën e shërbimit te Prishtinës.

Me shtruarjen e kontrollit te konsumatorëve nga ana e kontrollorëve dhe inspektorëve është ngritë edhe kërkesa për ndërrimin e Ujëmatësve.

Me qellim te parandalimit te manipulimit te ujëmatësve ky shërbim ka filluar vendosjen e pllombave ne Ujëmatësa.

Edhe pse me shumë vështirësira dhe pengesave ne pajisjet e laboratorit për kalibrimi, ky shërbim ka ofruar mundësit e kalibrimit te Ujëmatësve për kërkesa te konsumatorëve.

8.10.4.Shërbimi i makinerisë

Përveç intervenimeve ne rrjedhjen e gypave te çelikut dhe kontrollimeve te stabilimenteve ne Stacionet e Pompimeve, grupi i mirëmbajtjes së Makinerisë ka intervenuar ne **423** raste, dhe nëse e krahasojmë me vitin 2017 kemi pas një rritje te vogël te intervenimeve .

.

8.10.5.Shërbimi i elektrikes

Përveç kontrolleve rutinore te pajisjeve elektrike ne objektet e KURP, ku grupi i Elektrikes ka intervenuar gjithsej ne 478 raste, ne krahasim me vitin 2017 ka pas një rritje te vogël . Intervenimet kryesore kanë qen ne Pajisjet e vjetruara si dhe ne sistemet e klori mit ne Objektet e Qytetit

FINAL

8.10.6.Shërbimi i elektronikës

Ky shërbim gjatë vitit 2017 është integruar me shërbimin e elektrikes.

8.10.7.Stacionet e pompimit dhe rezervuarët në qytet

Objektet ne qytet kanë punuar ne distribuimin e ujit ne vartësi nga prurjet e FPU ne Batllave, Badovc dhe "Shkabaj "pa ndonjë problem te theksuar.

Me startimin e fabrikës se re ne Shkabaj dukshëm janë rrit prurjet ne Objektet dhe si rezultat nuk kemi pas reduktim te ujit për konsumatorë.

Problemi i Objekteve ne Qytet qëndron se këto objekte janë ne një gjendje te vështirë me qe shume pak është investuar ne Rehabilitimin sidomos ne Galeritë dhe ne Siguri te Punëtoreve

8.10.8.Shërbimi i detektimit te rrjedhjeve

Ne Vitin 2018 ky shërbim përveç inspektimeve ne Detektimin e rrjedhjeve si dhe matjeve te Presioneve ka bere monitorimin dhe përcaktimin e DMA zonave te matjeve.

Pilot zonave te formuara ne zonën e shërbimit ku pas intervenimeve te rrjedhjeve te detektuar rezultatet janë te prekshme kësaj përket Humbjeve Teknike.

Me poshtë ne grafikonin i paraqesim humbjet teknike sipas matjeve te te ber ne këto zona :

Pilot zona I me ujëmatës kryesor te Sh.F.Ismail Qemajli, ku humbjet teknike janë ne mesatare prej 5.41 %

Pilot zona II te Ngrohtorja, me humbje Teknike mesatare vjetore prej 6.04 %.

Pilot zona "Ulpiana", me humbje Teknike mesatare vjetore prej 6.24 %.
Janë vendose edhe Ujëmatësit tjerë zonal, nga Faza e dyte e Donacioneve për formimin e Zonave te matjes, dhe me integrimin e tyre ne Modulin e faturimit apo me Sistemin e GIS-it do te kontrollohen me detajisht humbjet e mundshme Teknike dhe Komerciale

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Zona I	8.28%	7.30%	7.50%	6.30%	4.55%	4.27%	4.54%	4.60%	4.49%	4.38%	4.35%	4.34%
Zona II	5.93%	5.83%	6.15%	6.26%	6.14%	6.29%	7.02%	7.78%	7.21%	7.11%	6.78%	7.97%
Ulpianë	8.30%	7.15%	6.34%	6.36%	6.30%	6.42%	7.05%	6.38%	5.80%	5.41%	3.18%	
Dardani										1.77%	1.56%	1.19%



Nga ky Grafikon shifet se DMA zonat kanë pas një progres respektivisht Ulje te humbjeve, përveç Zona II ne graf ka një rritje te vogël por ne total krahasuar nga vitet e kaluara ka pas ramje te dukshme.

FINAL

8.11. Raporti i departamentit të kualitetit të ujit

Qëllimi kryesor i Departamentit është organizimi dhe funksionimi i tij si Departament për Kontrollën e Kualitetit te ujit duke u bazuar në Standardet cilësore, aplikative (U.A.16/2012) dhe ato europiane (Udhëzimi –Direktiva 98/83/EC) mbi kualitetin e ujit për përdorim nga njerëzit (me pare direktiva 80/778/EEC). Kjo direktivë përcakton dallimet në mes të parametrave mikrobiologjik dhe atyre fiziko- kimik. Aplikimi i standardeve është në interes të gjithë konsumatorët e Prishtinës, Shtimes, F.Kosovë, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Drenasit dhe Graçanicës. Departamenti i Kualitetit të Ujit me planin e tij të monitorimit brendshëm të kualitetit të ujit ka në procedurë pikë së pari mbledhjen marrjen e mostrave të ujit të përpunuar nga rrjeti i ujësjellësit, aeratorëve, liqejve , puseve dhe lumejve.

Laboratorët shfrytëzojnë metoda standarde për parametrat të cilat janë të aprovume nga BE, sipas procedurës të cilat janë dhënë me Direktivën 98 (93) EC. Mjetet dhe aparatet janë të sofistikuara kurse reagjentët janë të standardizuar dhe me afat. Aplikohet standardi 17025:2005 ku janë kërkesat që laboratoret e testimit duhet të plotësojnë nëse ato dëshirojnë të demonstrojnë që ato operojnë një sistem menaxhimi.

Përshkrimi i shkurtër i punëve të kryera brenda periudhës raportuese;

Sipas planit gjashtëmujor për monitorimin e brendshëm të kualitetit të ujit në të gjitha zonat e Shërbimit ku mbulohet me ujë të KUR"Prishtina" sh.a, në aplikim të monitorimit të shpejtë bazik dhe vijues kemi percjellë kualitetin e ujit të pijshëm në çdo pikë mostrimi.

Cilësia e ujit është e kontrolluar dhe testuar me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike sipas parametrave të cilët jane në Listën A dhe C në Udhëzimin Administrativ Nr.16/2012 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriut.

Përveq kontrrollës së cilësisë së ujit pijshëm,që është primare dhe thelbsore Departamenti gjat muajit Janar- Dhjetor 2018 ka zhvillu aktivitet të ndryshme:

b) Monitorimin dhe analizimin e kualitetit te ujit siperfaqsor lumejve, liqejte, puset nëntoksore, rezervuaret e ujit ku deponohet ujë në objekte prodhuese dhe distribuese , përcaktimi i dozimit të kemikateve dozuese Klorit gaztë, Sulfatit Aluminit, Permanganatit të Kaliumit, Polielektrolitëve;

c)Verifikimi ose Inspektimi në teren në bashkëpunim me inspektoret e çkyqjeve për te qartësu dyshimet se a po keqpërdoret ujë i pijshëm nga qytetaret;

d) Aktivitet tjetër gjatë vitit është pranua në punë një teknike e kimisë

e) Është bë auditimi vjetor i Sistemit te Manualit të Cilësisë ose ndryshe quhet Sistemi i Menaxhimit të Laboratorit për Akreditim.

f) Është bërë mbikëqyrja e dytë nga DAK- u për procedurat e akreditimit

g) Janë testu mostra te ujërave te zeza ne Impiantin per trajtim te ujërave te zeza dhe pas trajtimit Mramor,

i) Gjatë muajit Nëntor janë përgatit projektet për planin e prokurimit

h) Raportet mujore dhe raportet e shpenzimeve te kemikateve :sulfat aluminit, klorit,cpermanganat kaliumi,cpolielektrolitit,csulfat bakri.

FINAL

Punët e planifikuara dhe shkalla e realizimit të tyre;

Departamenti i Kualitetit të Ujit si prioritet ka kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm . Realizimi vjetor 2018, mostra total fiziko-kimike dhe bakteriologjike kane qene 13654 i cili plan nuk është realizuar për 20 mostra ose në përqindje 99.85%. Te planifikuara kanë qenë 13674 mostra ky numër i mostrave 20 (0.15 %) më pak ka rezultu për shkak te problemeve teknike ndërprerje e rrymës në FPU Albanik, Badovc dhe Shkabaj , nga reduktimet e ujit ne NJOU"Fushë Kosovë", NJOU"Drenas", "Podujevë","Lipjan" dhe "Shtimje".

Anex: Tabela krahasuese me planin ose me periudhën e njëjte të vitit paraprak;

Numri i i testimeve të kryera:	**6827** Teste fiziko-kimike
	6827 Teste bakteriologjike
	13654 Total fiziko-kimike dhe bakteriologjike
Rezultatet e fituara nga laboratori:	11636 Teste ujë pijshëm (përpunuar)
	2018 Teste ujë jo i pijshëm (papërpunuar)
	66 Mostra nuk i përgjigjen
Rezultatet e raportuara	Rezultatet tregojnë se prej 11636 mostrave fiziko-kimike dhe bakteriologjike te ujit pijshëm 11570 mostra ose 99.43 % i përgjigjen standardit sipas U.A Nr.16/2012 për cilësi të të ujit për konsum nga njeriu kurse 66 mostra ose 0.57% në aspektin bakteriologjik 62 dhe kimik 4 janë jashtë standardit për ujë të pijshëm.
	Rezultatet e 2018 mostrave te kryera për ujëra të papërpunuar i përgjigjen Standardeve për kualitet të ujit për ujë të papërpunuar.
Gjendja e pajisjeve:	E rregullte dhe funksionale!
Infrastruktura:	Gjate muajit janar dhe shkurt temperatura ka qene në laborator nën kushtet optimale 22ºC për shkak te sistemit te klimatizimit qe nuk ka funksionu ne temperatura të ulëta minus (-). Në mëngjes temperatura ne laborator ka qenë rreth 10ºC ku gjatë ditës ka mbërri deri ne 17º C.Ky ndryshim i temperaturës jo vetëm qe ndikon në aparaturë ,ndikon edhe në efikasitetin e punës se stafit.
Efikasiteti i punës së stafit:	Korrekt , i mirë

FINAL

8.12.Raporti i departamentit të mirëmbajtjes dhe trajtimit të ujërave të zeza

Departamenti ka për detyrë organizimin dhe funksionimin për mirëmbajtjen e sistemit te kanalizimit dhe trajtimin e ujerave te zeza duke u bazuar dhe plotësuar standardet sipas udhëzimit administrative. Në nivel të Departamentit është ngritur në fillim te vitin 2018.

Ky Departament bënë mirëmbajtjen e sistemit te kanalizimit te KRU "PRISHTINA" sh.a, në të gjithë zonën e shërbimit qe janë 8 komuna - ka në menagjim 1093 km rrjete te kanalizimit. Angazhimin e gjithë potencialit të vet, të ekspertëve , punëtorëve, mekanizmit dhe pajisjeve teknike që posedon, që të kryejë punët në kohë dhe me rezultate të kënaqshme. Bënë pastrimin , de bllokimin dhe sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në Zonën e shërbimit të të gjitha defekteve, bllokimeve dhe pengesave tjera që paraqiten.

Trajtimi i ujërave të zeza

Trajtimi e ujerave te zeza behet duke u bazuar ne udhëzimin administrativ MMPH – Nr.30/2014 për kushtet , mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujerave të ndotura ne rrjetin e kanalizimit publik dhe ne trupin ujor. Ky udhëzim përcakton kriteret e përgjithshme për shkarkimin e ujerave te ndotura, cakton parametrat fiziko-kimike dhe atyre bakteriologjik. Ne kuadër te departamentit kemi dy impiante te Trajtimit te ujerave te zeza.

1. Impiantin e trajtimit te ujerave te zeza ne Halilaq - gypi prurës i kanalizimit fekale është 250mm ku me pompohet deri te impianti biologjik. Impianti përbëhet nga një SBR reaktor (Sequencing Batch Reactors) ku procesi i trajtimit kontrollohet përmes kompjuterëve industrial, dhe uji i trajtuar me gravitet shkarkohet ne receptor.

Kapaciteti i Impiantit është 1230 PE (banor ekuivalent),

Mesatarja ditore i ujerave te ndotur infloë Q24 =147,6 m3/dite = 1,71 l/s

Maksimumi ditore i ujerave te ndotur infloë Qd =206,64 m3/dite = 2,39 l/s

Maksimumi ore i ujerave te ndotur infloë Qh = 450,475 m3/h = 5,21 l/s

2.Impiantin e trajtimit te ujerave te zeza ne Mramor – Badoc -

Gypi prures ne impiant është 150mm.Impianti përbëhet nga dy SBR reaktor (Sequencing Batch Reactors) ku procesi i trajtimit kontrollohet përmes kompjuterëve industrial, dhe uji i trajtuar me gravitet shkarkohet ne receptor.

Kapaciteti i Impiantit është 2400 PE (banor ekuivalent),

Maksimumi ditore i ujerave te ndotur infloë Qd =500 m3/dite = 5,78 l/s

Aktivitetet dhe përshkrimi i punëve të kryera gjate vitit 2018;

FINAL

Gjatë vitit 2018 janë paraqitur 3696 raste te bllokimeve ne kanalizim, ku gjate kësaj periudhe janë kryer gjithsej 3892 intervenime ne debllokim te kanalizimin, pastrim te pusetave dhe vendosje te kapakëve te pusetave ne gjithë zonën e shërbimit te KRUP

Krahasim i rasteve te paraqitura per vitin 2017/2018:

Viti/ Muaj	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
2017	203	374	265	272	352	302	337	302	255	289	233	367	3551
2018	203	221	221	248	345	407	409	394	280	318	279	371	3696

Grafikisht është paraqitur rastet e paraqitura ne krahasim me periudhën e njëjtë te vitit paraprak,



Krahasim i rasteve te kryera për vitin 2017/2018:

Viti	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
2017	160	212	234	270	360	295	294	343	254	276	334	289	3551
2018	281	228	186	292	343	394	396	389	320	335	371	357	3892



Grafiku i intervenimeve ne krahasim me periudhën e njëjtë te vitit paraprak, me këtë vijmë ne përfundim se rrjeti i kanalizimit është i vjetër dhe vetëdijesimi i popullatës është i ulet për shkarkimet ne rrjetin e kanalizimit.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor te vitit 2018 janë pastruar 184 puseta nga mbetjet e ngurta dhe janë vendosur 37 kapak të pusetave aty ku kanë munguar ose kanë qenë të dëmtuar- thyer.

Më tej po specifikojmë disa nga aktivitetet kryesore;

a) Përgatitja e specifikacioneve teknike për projektet e planifikuara në Plan Prokurimit

- Përgatitja e paramases dhe specifikacionit për furnizim me pompe për mirëmbajtje te rrjetës se kanalizimit dhe mjetet e punës.
- Përgatitja e paramasës dhe specifikacionit për projektit “Ndërtimi dhe Riparimi I pusetave te ujësjellësit dhe kanalizimit ne Zonën e KRUP Sh” sipas planit te prokurimit.

b) Sanimi i rrjetit te kanalizimit dhe riparimi i pusetave

Janë bere sanime dhe intervenime me ekipet e operimit dhe mirëmbajtjes ne kuadër te departamentit ne forme me te detajuar te gjitha rastet jane prezantuar ne raportet mujore

c) Bashkëpunimi me K Komunale ne zonën e shërbimit për diskutime rrethe mirëmbajtjes dhe investimeve – planifikimeve ne rrjetat e kanalizimit fekale

- Bashkëpunimi me Komunat ne zonën e shërbimit për planifikimet e sistemeve te kanalizimit duke bashkëpunuar dhe mbikëqyrur disa projekte ne baze te kërkesave te autoriteteve Komunale.

c). Aktivitete tjera për ngritjen e kapaciteteve ne dhënien e shërbimit ne mirëmbajtjen e rrjetave te kanalizimit dhe planifikimin.

- Vizita e përfaqësuese Hungarez për investime me aparaturë montuese ne puset për bluarjen e mbetjeve ne kanalizime fekale. Trajnimi nga RCDN ne Ngritje te Kapaciteteve ne dhënien e shërbimeve në rrjetin e ujit dhe kanalizimit.

FINAL

9. Pasqyrat financiare

9.1. Pasqyra e të ardhurave

Pasqyra e të ardhurave dhe fitimit të mbajtur për perjudhen 01.01.2018-31.12.2018		
Periudha Raportuese	31.12.2018	31-Dhjetor
Të hyrat operative	2018	2017
Të hyrat nga shërbimet e furnizimeve me ujë	14,267,001	14,220,393
Të hyrat tjera operative	43,539	181,927
Të hyrat nga grantet	2,149,196	1,562,369
Te hyrat totale	**16,459,736**	**15,964,689**
Shpenzimet operative		
Shpenzimet për blerje Uji të paperpunuar	(642,196)	(425,800)
Shpenzimet e energjise	(2,312,212)	(2,472,201)
Shpenzimet e karburanteve	(117,861)	(105,418)
Shpenzimet e personelit-paga dhe meditje	(5,137,160)	(5,036,900)
Shpenzimet materiale	(739,460)	(501,269)
Shpenzimet e interesit	(486,637)	
Sherbimet e jashtme kontraktuese	(703,808)	(569,362)
Shpenzimet e takses se MMPH 2011-2017	(365,954)	
Shpenzimet e rek., sportit, kultures dhe nd. solidare	(7,642)	(5,798)
Shpenzimet e mirembajtjes dhe riparimit	(117,000)	(119,429)
Shpenzimet e zhvleresimit dhe amortizimit	(6,539,319)	(5,305,904)
Shpenzimet e provizionimit te borxhit te keq	(30,437)	(869,929)
Te dalurat financiare dhe transferi i rezultatit fin.	(24,128)	(23,244)
Shpenzimet totale	**(17,223,814)**	**(15,435,253)**
Fitimi-Humbja operative	(764,078)	529,437
Të hyrat nga interesi në depozitat bankare	13,063	4,695
Fitimi-Humbja para tatimit	(751,015)	534,132
		(53,413)
Fitimi / Humbja e vitit	(751,015)	480,718

Shenim: Raport shpjegues mbi pasqyrën e të ardhurave për vitin 2018

Gjatë viti 2018, performanca financiare në aspektin e të hyrave ka shënuar rritje prej 46,000 € nga shitja prej 14,220,393 € sa kanë qenë gjatë vitit 2017 në 14,267,001 € shitje të shërbimeve bazë. Sa i përket indikatorëve tjerë të të hyrave kemi një rritje më të lartë në të hyrat nga grantet për 586,827 € në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017. Si rrjedhojë totali i të hyrave operative në vitin 2018 ka qenë 16,472,799 kurse në vitin 2017 ka qenë 15,964,689 € që shënon një rritje mbi 3% të totalit të të hyrave. Edhe pse të hyrat nuk kanë pësuar rritje të konsiderueshme, gjithsesi rritja ngelet në trend pozitiv.

Shpenzimet tjera të cilat në masë më të vogël kanë shënuar rritje, lidhen me shpenzimet e blerjeve të ujit të papërpunuar, shpenzimet e karburanteve, pagat, shpenzimet materiale, dhe kontraktimet e jashtme. Në anën tjetër shpenzimet e energjisë, shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit si dhe shpenzimet e

FINAL

provizionimit të borxhit të keq kanë shënuar rënie. Kryesisht, efekti i rritjes apo dhe rënies së shpenzimeve lidhet ngushtë me trendin e ngritjes/ rënies së çmimeve të këtyre shërbimeve/ produkteve. Ne vitin 2018 rritja e shpenzimeve të tjera duke përjashtuar shpenzimet e tatimit, interesit dhe amortizimit ka qenë më e lartë në vlerë prej 561,019 €. Kjo rritje e shprehur në përqindje është rreth 5% më më e lartë në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017.

Humbjet e ujit gjithashtu janë një faktor tjetër që në mënyrë direket afektojnë edhe performancën financiare të ndërmarrjes. Në vitin 2017 distribuimi i ujit ka qenë 52.087.383 m3 ujë kurse janë faturuar 22,301,582 m3 ujë, shprehur këtë humbje të ujit në përqindje, në vitin 2017 humbjet kanë qenë 57%. Në vitin 2018 kemi distribuuar 51,743,595 m3 ujë kurse kemi faturuar 21,841,206 m3, shprehur humbjen në përqindje ka qenë 58%. Kjo rritje e humbjeve të ujit në shkallë prej 1% ka afektuar nivelin e përgjithshëm të shitjeve negativisht (në vitin 2018 kemi faturuar më pak se në vitin 2017 në masë prej 460,376 m3 ujë).

Aktiviteti financues është rritur në masë të konsiderueshme dhe këtu vlen të theksohen shpenzimet e Zhvlerësimit dhe amortizimit dhe shpenzimet e interesit. Duhet pasur parasysh se në vitin 2018 është bërë kontabilizimi i investimeve në Badovc në vlerë prej 12 milion € (për periudhë 6 mujore) si dhe amortizimi I fabrikës Shkabaj për një vit të plotë financiar. Gjithashtu, në pasqyrat financiare të vitit 2017 nuk kemi shpenzime të interesit si rrjedhojë e kapitalizimit të aseteve, ku në vitin 2018 ky shpenzim arrin vlerën prej 486,637 €. Andaj si pasojë e këtyre dy kategorive të shpenzimeve, fitimi neto ka shënuar këtë rënie (pra si rezultat i aktivitetit financus të njohur po në këtë periudhë)

Ndërmarrja për vitin 2018 ka shënuar humbje prej 733,524 € kurse në vitin paraprak ka pasur fitim prej 480,000 €. Kjo performancë kryesisht lidhet ngushtë me aktivitetin financues të ndërmarrjes dhe në shkallë shumë të ulët me aktivitetin shpenzues të realizuar në vitin 2018. Ndërmarrja ka realizuar një shpenzim prej 365,954 € për shpenzimet e taksës së MMPH (që nuk janë njohur- regjistruar ndërmjet viteve 2011- 2017), shpenzim ky që ka qenë jashtë planifikimit. Duke pasur parasysh se aktiviteti shpenzues ngelet në suaza të normales për të gjitha kategoritë e shpenzimeve tjera.

Duke u bazuar në të hyrat para interesit, tatimit, dhe amortizimit. Duke u bazuar në këtë matës të performancës, në vitin 2018, ndërmarrja ka shënuar rritje të të ardhurave prej rreth 400,000 € krahasuar me vitin 2017. Më saktësisht, të ardhurat sipas kësaj përllogaritje, në vitin 2018 janë 6.2 milion € krahasuar me vitin 2017 prej, 5.8 milion €.

FINAL

9.2. Pasqyra e pozitës financiare

Pasqyra e Pozitës finaciare më: 31.12.2018			
Pershkrimi	**Note**	**31-dhjetor**	**31-Dhjetor**
Pasuritë		**2018**	**2017**
Prona, Impiantet dhe Pajisjet	1	95,164,582	89,219,181
Investimet ne vijim	1.1		9,527,043
Pasuritë jo qarkulluese		95,164,582	98,746,224
Stoqet Neto	2	1,604,359	1,616,727
Llogarite e arkëtueshme	3	14,023,536	13,621,326
Kërkesat tjera	4	1,828,423	4,136,437
Paraja dhe Ekuivalentet e Parasë	5	4,319,492	5,224,093
Totali- Pasuritë		116,940,392	123,344,807
Ekuitetii dhe Detyrimet			
Ekuiteti			
Kapitali Aksionar	6	25,000	25,000
Rezervat	7	72,710,754	72,620,753
Fitimet-Humbjet e akumuluara	8	(9,569,759)	(10,049,648)
Fitimi/Humbja e vitit	8.1	(751,015)	480,718
Total ekuiteti		62,414,980	63,076,824
Obligimet afatgjate lidhur me kredite dhe grantet e shtyera	9	52,311,203	58,165,463
Total detyrimet afatgjate		52,311,203	58,165,463
Llogarite e pagueshme dhe detyrimet tjera	10	1,378,362	1,425,046
Tatimi i pagueshëm	11	835,847	677,473
Total detyrimet afatshurter		2,214,209	2,102,520
Total detyrimet		54,525,412	60,267,983
Total detyrimet dhe ekuitetit		116,940,392	123,344,807

FINAL

9.3. Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë për perjudhen Jan - dhjetor 2018			Metoda Indirekte
Pershkrimi	**Note**	**31.12.2018**	**31.12.2017**
Fitimi (Humbja) para tatimit		(751,015)	534,132
Zhvlersimi	9	6,539,319	5,305,904
Detyrimet afatshkurta		(2,214,209)	(816,433)
Ndryshimi ne kerkesat afatshkurta	3	106,660	339,535
Te arketueshmet tjera tregtare		(402,210)	(1,258,415)
Te hyrat nga grantet	8	(2,149,196)	(1,562,369)
Lejimet për borxhet e këqija		30,437	869,929
Stoqet		14,349	7,308
Rrjedha neto e parase nga aktivitetet operative		5,699,159	3,419,590
Arketimet e parase nga shitja e pasurive joqarkulluese, prekshme	4		
Arketimet e parase nga shitja e prones dhe instrumenteve te borxhit	5		
Arketimet e parase nga interesi	10&11		
Arketimet e parase nga dividentat			
Arketimet tjera te parase nga akt investuese			
Pagesat e parase per blerjen e pasurive joqarkulluese, prekshme		(4,374,054)	(4,961,559)
Pagesat e parase per blerjen e prones dhe instrumentet e borxhit			
Pagesat tjera te parase per aktivitetet investuese			
Rrjedha neto e parase nga aktivitetet investuese		(4,374,054)	(4,961,559)
Arketimet e parase nga emitimi I instrumenteve financiare			
Arketimet e parase nga kryegjeja e kredise, fleteobligacionet, huate		454,417	1,418,444
Arketimet tjera te parase nga akt financuese	3		
Pagesat e parase per kryegjen e kredise dhe fleteobligacioneve		(2,222,000)	(2,222,000)
Pagesat e parase per dividenta			
Pagesat e parase per lizing financiar			
Pagesat e parase per riblerjen e aksioneve vetiake	6		
Pagesat tjera te parase per aktivitetet financuese	9		
Rrjedha neto e parase nga aktivitetet financuese		(1,767,583)	(803,556)
Rrjedha neto e parase		(442,478)	(760,515)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim	7	4,763,578	5,524,093
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund	7	4,321,100	4,763,578

FINAL

9.4. Pasqyra e ndërrimeve në ekuitet

Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet për vitin 31.12.2018				
Përshkrimi	**Kapitali aksionar**	**Rezervat kapitale**	**Fitimet (Humbjet) e akumuluara**	**Totali**
Me 01 Janar 2018	25,000	72,620,753	-9,568,929	62,596,106
Fitimi /humbja e vitit			-751,015	479,889
Korrigjimi i humbjeve te bartura (shënimi 7)				0
Me 31 Dhjetor, 2018	25,000	72,710,753	-10,319,944	63,075,995
Fitimi /humbja e vitit			0	0
Korrigjimi i humbjeve te bartura (shënimi 7)				
Me 31 dhjetor, 2018	25,000	72,710,753	(10,319,944)	63,075,995

FINAL

9.5. Shpalosjet (në Ankes)

POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Pasqyrat financiare për vitin që përfundon më: 31.12.2018 paraqesin gjendjen reale të "KRU " Prishtina" SH.A.me seli në Prishtinë.

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare te bashkëngjitura janë përgatitur në përputhje me SKK dhe SNK dhe Raportimit Financiar

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë raportuar ne Euro, e cila është monedha funksionale e Kompanisë.

Bazat e përgatitjes

Hartimi dhe përpilimi i pasqyrave financiare është bërë duke u nisur nga parimi i vazhdimësisë së biznesit dhe janë përgatitur nën konventen e Kostos Historike dhe bazat e matjes janë shpjeguar më detajisht në politikat e kontabilitetit më poshtë.

Janë në perdorim 6 module:

- Moduli i faturimit.
- Moduli i pagave dhe resurseve humane.
- Moduli i asseteve.
- Moduli i materialeve-financiar dhe material dhe
- Moduli i depos-material të veçanta të pakos "Pronet" të cilat në mënyrëgjysmë të automatizuar janë të lidhura me modulin Libri kryesor-kontabiliteti.
- Moduli i kontabilitetit.

Mbajtja e evidencës kontabël përkatësisht e veprimeve të tjera financiare e përfaqsuar përmes moduleve rregullohet me Parime te ndryshme të brendshme, Rregullore, Rregulla, Udhëzime dhe Vendime.

Me këto rregullohen fusha të ndryshme të veprimtarisë së rregullt të Kompanisë Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" sh.a.

Transaksionet ne monedhë të huaj

Të gjitha llogarite bankare janë në monedhën Euro dhe po ashtu të gjitha transaksionet kryhen në monedhën e Euros. Nuk kemi transaksione në monedhë të huaj.

FINAL

Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të Kompanisë përbëjnë llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesa të tjera, paranë dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme dhe të tjera dhe kreditë e huamarrjes që mbartin interes. Instrumentet e tilla financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus ndonjë shpenzim që i atribuohet drejtëpërdrejtë transaksionit.

Kompania fillimisht njeh të arkëtueshmet dhe depozitimet e parasë në datën kur ato janë krijuar- parimi akrual.Të gjitha pasuritë e tjera financiare njihen fillimisht me datën e tregtimit në të cilën kompania bëhet palë në kushtet kontraktuale te instrumentit.

Kompania ç'regjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferohen të drejtat e marrjes së rrjedhës monetare nga pasuria financiare në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë

financiare janë transferuar. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Kompania është i njohur si pasuri apo detyrim i veçantë.

Pasuritë dhe detyrimet financiare kompenzohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë kur kompania ka të drejtë ligjore për të kompenzuar shumat ose të shlyej mbi një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyej detyrim në të njëjtën kohë. Instrumentet financiare jo-derivative të kompanisë përbëjnë të arkëtueshme të tjera, paranë dhe ekuivalentët e saj dhe të pagueshmet tregtare dhe të tjera.

Instrumentet financiare

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë bilancet e parave të gatshme, llogaritë bankare dhe depozitat me afat .

Paraja e gatshme ruhet ne llogaritë bankare të bankave komerciale që funksionojnë në Kosovë. Risku është i shpërndarë në shumë banka. Menagjimi i parasë së gatshme bëhet në bazë të vendimeve, udhëzimeve dhe rregullave të shkruara. Në fund të vitit fiskal është bërë regjistrimi fizik i parasë së gatshme në arkë dhe barazimi formal midis librave kontabël dhe evidencës bankare.

Të arkëtueshmet dhe kërkesat tjera

Evidenca analitike e llogarive të arkëtueshme në bazë të shitjeve nga veprimtaria bazë mbahet në modulin e vecantë-Faturimi.

Vlerat e prezentuara në bilancin e gjendjes është paraqitur në vlera neto, duke zbritur provizionin për borxhet e këqija. Provizionimi është bërë me metodën e provizionimit të përgjithshëm. Provizionimi është bërë në bazë të rregullës për këtë qëllim dhe mbështetet në shkallët e provizionimit të lejuara dhe konform ligjeve në fuqi. Për provizionimin e borgjeve të këqija kemi siguruar të gjitha dëshmitë si: vërejtjet, thirrjet për pagesë, raportet e shkyqjeve, njoftimet përmes mediave, rastet që kanë shkuar te përmbaruesi. Duke u bazuar në vlerën e borgjeve të papaguara që i kemi ndjekur të gjitha proceduarat sipas Ligjit Nr. 05/L-029 Për Tatimin në të ardhurat e korporatave kemi llogaritur vlerën **30,437 €** në

emër të shpenzimeve të borgjit të keq. Në këtë vlerë janë të paraqitura vetëm rastet që i kemi derguar ne permbarim dhe mundesite qe te arketohen keto borgje jane te vogla.

Kërkesat tjera janë të përfaqësuara në një numër të caktuar të llogarive që përfaqsojnë Llogari të arkëtueshme mbi bazën e shitjeve te shërbimeve sekondare si: paradhënjet për investime kapitale, kërkesat ndaj personelit dhe kërkesat e pazbardhura, dhe të tjera të ndryshme.

Instrumentet financiare

Kapitali aksionar

Akcionari-përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës si akcionar i vetëm në vlerë totale ka lëshuar këto aksione përfshirë 25.000 aksione në vlerë nominale prej 1 € për cdo aksion. KRU "Prishtina" sh.a. posedon vendimin e aksionarit dhe çerifikatën e aksioneve.

Rezervat e rivlerësimit

Rezervat e rivlerësimit pasqyrojnë diferencën positive të vlerësimit të pasurive dhe humbjeve të bartura-përkatësisht fitimeve të pashpërndara në momentin e koorparatizimit. Rivlerësimi është bërë nga "Grant Thornton" dhe është funksional me gjendjen fillestare 01.01.2007

Pronat, Impiantet dhe paisjet maten me kosto duke i zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia ne vlerë. Kosto përfshinë shpenzime që janë drejtëpërdrejtë të ngarkueshme me blerjen e pasurisë.

Pronat, impianet dhe pajisjet

Pronat, Impiantet dhe paisjet maten me kosto historike duke i zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Kosto përfshinë shpenzime që janë drejtëpërdrejtë të ngarkueshme me blerjen e pasurisë.

Kosto e pasurive të vetëndërtuara përfshinë koston e materialeve dhe punës së drejtëpërdrejtë me vënien e pasurisë në gjendjen funksionale për përdorimin e synuar. Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ata kontabilizohen si zëra të veçantë të pronës, impianteve dhe pajisjeve.
Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të pasurive afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të pasurive dhe njihen neto si "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave (në fitim ose humbje).
Pronat në rrjedhën e ndërtimit për prodhim ose për qështje administrative ose për qëllime ende të papërcaktuara, barten në kosto, minus çdo humbje nga zhvlerësimi i njohur. Kosto përfshinë tarifat profesionale, kostot e huamarrjes kapitalizohen në përputhje me politikat kontabël të Kompanisë. Zhvlerësimi i këtyre pasurive, në të njëtën bazë si aktivet e tjera të pronësisë fillon kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar.

Pronat, impianet dhe pajisjet

Mobilet, orenditë, pajisjet dhe automjetet paraqiten me koston e tyre duke i zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe pa humbjet e akumuluara nga dëmtimet. Mobilet, orenditë, pajisjet dhe automjetet e KRU "Prishtina" sh.a. mbahen ,menaxhohen dhe kontabilizohen në modulin e vecantë në kuadër të softwerit"Navision".

Zhvlerësimi i asseteve është bërë në mënyrë drejtëvizore-lineare për të gjitha assetet. Normat e zhvlerësimit janë nxjerrë nga Ligji për Tatimin në të ardhurat e korporatave nr. Nr. 05/L-029 të përkatësisht nenin 15 pika 3.
Shpenzimet vjetore që njihen si shpenzime të zhvlerësimit për vitin 2018 kapin vleren 6,539,319.55 euro.

Zhvlerësimi llogaritet në atë mënyrë që të zvogëloj koston ose vlerësimin e pasurive, përveç Tokës dhe projekteve në ndërtim e sipër gjatë jetës së tyre të vlerësuar të përdorimit duke përdorur metoden lineare si vijon:

- Ndërtesat dhe Rrjeti i Ujësjellësit dhe kanalizimit 20 vite
- Impiantet dhe Makinerite 5-10 vite
- Moblilet dhe pajisjet 5 vite
- Automjetet 5-10 vite

Në bazë të shtesave dhe hudhjeve gjatë vitit, shpenzimi ngarkohet prej muajit të blerjes e deri te muaji përkatës i asgjësimit.

Jetët e vlerësuara të përdorimit, vlerat e mbetura dhe metodat e zhvlerësimit rishikohen në çdo fund vit, me efektin e ndonjë ndryshimi me vlerësimet kontabël në të ardhmen.

Pasuritë e paprekshme

Fitimi ose humbja që vjen nga hudhja ose asgjësimi i ndonjë pjese të pronave, impianteve ose pajisjeve përcaktohet si një diferencë në mes të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të një aseti dhe është e njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

Kostot pasuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si pasuri e ndarë sipas rastit, sipas nevojës vetëm atëherë kur është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen të lidhura me atë artikull do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e artikullit do të matet në mënyrë të sigurt. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera paraqiten në pasqyrën e të ardhurave ose humbjeve dhe të të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Njohja dhe matjet

Pasuritë e paprekshme përbëhen nga licencat dhe programet kompjuterike. Këto pasuri të paprekshme janë paraqitur fillimisht me kosto dhe më pas me koston e tyre duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga rënia në vlerë. Amortizimi është njohur në bazë lineare përgjatë jetës së pritshme të përdorimit. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësim duke llogaritur në baza të ardhme.

Shpenzimet pasuese

Shpenzimet pasuese janë kapitalizuar vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike për të cilën ato lidhen, Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë edhe për emrin e mirë të krijuar brenda, nijihet në fitim apo humbje në momentin kur ndodhin.

FINAL

Pasuritë e paprekshme

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e Pasurisë, duke i zbritur vlerën e saj të mbetur. Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare për softwer me një normë vjetore prej 20%.

Stoqet dhe inventarët

Stoqet dhe inventarët maten me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Kostoja e tyre është e bazuar në parimin e "çmimit mesatar" dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara me rastin e blerjes së inventarëve, kostot e prodhimit apo të konvertimit dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara në sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes.

Materialet dhe pjesët rezervë janë shpenzuar ose kapitalizua , kur instalohen.

Evidenca e stoqeve te materialeve ne depo mbahet në dy module të ndara;

1. Moduli i kontabilitetit material dhe financiar dhe
2. Modulin e kontabilitetit material-Depos.

Komisioni i vecantë në fund të vitit fiskal ka bërë regjistrimin përkatësisht numrimin –inventarizimin fizik stoqeve dhe inventarëve. Komisioni qëndror i regjistrimit ka parashtruar raportin përfundimtar.

Pershkrimi	Kontot	Vlera
Materiali hargjues	1000	1,404,995.68
Lendet djegese	**1001**	39,320.11
Mjetet mbrojtese ne pune	1002	0.00
Inventari i imet	1003	15,174.65
Auto gomat	1004	828.82
Materiali i zyreve	1005	1,889.59
Pjeset rezerve	1006	10,053.61
Materiali hargjues per kemikalje dhe reagenca	1007	0.19
Inventar dhe mjete mbroj. Gratis Kfori Cek	1008	358.00
Shpenzimet akruale	1009	-38.80
Materiali i ndryshem ne depo-Podujeve	1010	15,295.45

FINAL

Material i ndryshem ne depo-Lipjan	1011	23,441.30
Materiali rezerv ne NJOU-Gllogovc	1012	41,818.62
Dallimet ne çmime	1060	-20,420.84
Inventari i imet ne perdorim	1080	61,544.14
Autogomat ne perdorim		10,098.49
Total stoqet		**1,604,359.01**

Rënia në vlerë

Pasuritë financiare

Pasuritë financiare janë vlerësuar për indikacione të rënies në vlerë në fund të çdo periudhe raportuese. Pasuritë financiare bien në vlerë kur ka një evidencë objektive që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë financiare, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare të ardhshme të investimit janë ndikuar.

Humbja nga rënia në vlerë e një pasurie financiare të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferenca midis vlerës së saj kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të vlerësuara të ardhshme të skontuara me normën fillestare të ineteresit efektiv. Për pasuritë financiare të matura me kosto, vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare është llogaaritur duke përdorur normën e tregut të kthimit për pasuri të ngjashme.

Pasuritë financiare të rëndësishme janë testuar për rënie në vlerë për baza individuale.

Pasuritë financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në grupe që ndjanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje). Humbja nga rënia në vlerë rimirret nëse ky kthim mund të lidhet objektivisht me një ngjarje pasi humbja nga rënia në vlerë është njohur. Për pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar kthimi është njohur në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

Pasuritë jo financiare

Ne fund të çdo periudhe raportimi, kompania rishikon vlerat kontabël të pasurive të saj jo financiare për të përcaktuar nëse kanë pësuar një humbje nga rënia në vlerë.

Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë në mënyrë që të përcaktohet shkalla e humbjes (nëse ka). Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është shuma më e madhe në mes të vlerës së saj në përdorim ose vlerës së saj të drejtë minus kostot për shitje.

FINAL

Rënia në vlerë

Pasuritë jo financiare

Në vlerësimin e vlerës në përdorim , flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për kompaninë. Për qëllim të testimit të rënies në vlerë pasuritë grupohen së bashku në grupin më të vogël të pasurive që gjeneron flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhduar që janë kryesisht të pavarura nga flukset monetare hyrëse të pasurive tjera ose grupeve të pasurive.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme . Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje).

Grantet Qeveritare

Një grant qeveritar njihet vetëm atëherë kur ekziston një siguri e arsyeshme mbi kushtet prej të cilave përbëhet granti dhe që granti do të pranohet.

Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës që nevojitet të përputhet e ardhura me kostot e lidhura, për të cilat ata janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike.

Nëse një grant bëhet i ripagueshëm, duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësimin. Kur granti është lidhur me të ardhurat, shlyerja duhet të zbatohet fillimisht kundër ndonjë detyrimi të lidhur të paamortizuar të shtyrë, dhe çdo tejkalim duhet të trajtohet si shpenzime. Kur granti ndërlidhet me një pasuri, shlyerja duhet të trajtohet si rritje në vlerën kontabël të pasurisë ose zvogëlimin në bilancin e të ardhurave të shtyera. Amortizimi kumulativ do të ishte ngarkuar, nëse granti nuk ishte pranuar, duhet të ngarkohet si shpenzim.

Një grant i arkëtueshëm si kompenzim për shpenzimet e bëra tashmë ose për mbështetje të menjëhershme financiare, pa shpenzime të lidhura me të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën ai është i arkëtueshëm.

Grantet Qeveritare

Përfitimi i një granti në një normë të ulët të interesit të tregut, trajtohet si grant qeveritar i matur nga diferenca midis të ardhurave të pranuara dhe vlerat e drejta të kredisë të bazuar në normat aktuale të interesit të tregut.

KRU “Prishtina” sh.a. edhe gjatë vitit 2018 ka njohur të hyra të shtyera dhe ka njohur grante. Grantet kanë qenë të orientuar në zgjerimin e rrjetës së ujësjellësit dhe në ndertimin e Fabrikes së re në Shkabaj si dhe në fusha të tjera.

Gjatë vitit aktual janë njohur si të hyra nga grantet e shtyera vlera prej 2,149,196.04€, njejta vlerë është përllogaritur edhe si shpenzim operativ (zhvlerësimi i asseteve) përkatësisht shpenzime operative te mirembajtjes.

FINAL

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare përfshijnë huamarrjet dhe llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera që maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse.

Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat e vlerësuara monetare të ardhshme (duke përfshirë të gjitha shumat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërse të normës së interesit efektiv, kostot e transaksionit dhe promitë e tjera ose uljet) nëpërmjet jetës së detyrimit financiar, ose sipas rastit një periudhë më të shkurtër, në vlerën bartëse neto në njohjen fillestare.

Njohja e të hyrave

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të marrë ose të arkëtueshme.

Kur rezultati i një transaksioni që përfshinë kryerjen e shërbimeve mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, të ardhurat e lidhura me transaksionin do të njihen duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese. Rezultati i një transaksioni mund të vlerësohet i besueshëm kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë përmbushur:

a) Shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme

Njohja e të hyrave

b) Është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të rrjedhin tek njësia ekonomike

c) Faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet në mënyrë të besueshme dhe

d) Kostot e shkaktuara për transaksionin dhe kostot për të përfunduar transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme

Përfitimet e punëtorëve

Kompania, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në emër te vet dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionin e detyrueshëm sipas legjislacionit vendor. Shpenzimet e bëra në emër të Kompanisë janë ngarkuar në pasqyren e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Detyrimet kontigjente

Detyrimet kontigjnte njihen kur Kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundshme që Kompania do të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe një vlerësim i besueshëm nuk mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

Shuma e njohur si detyrim kontigjent është vlerësimi më i mirë i shumës që kërkohet për të shlyer detyrimin aktual në datën e bilancit, duke marrë parasyshë rreziqet dhe pasiguritë që e rrethojnë detyrimin. Kur një provizion matet duke përdorur rrjedhat e vlerësuara të flukseve monetare të

nevojitura për të shlyer detyrimin aktual, vlera e tij kontabël është vlera aktuale e këtyre flukseve të mjeteve monetare (kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material).

Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer një provizion pritet që të rikthehen nga një palë e tretë, një e arkëtueshme njihet si pasuri nëse është pothuajse e sigurt që rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet në mënyrë të besueshme.

Gjatë vitit 2018 rastet të cilat janë në procese gjyqësore, vlera e parashikuar e tyre mund të jetë rreth 200,000.00 €. Po ashtu kemi edhe një ankesë prej kompanise Strabak për mos finalizim të shpronësimeve me kohë dhe kompania ka pasur vonesa ne ekzekutim të punimeve, mirëpo KRUP është duke negociuar dhe nuk dihet se a do te kemi ndonje shpenzim lidhur me këtë qështje.

Në tabelën në vijim janë paraqitur rastet në të cilat KRU "Prishtina" sh.a. ka qënë e Paditur dhe rastet aktualisht janë në shkallën e dytë – Gjykata e Apelit:

Nr.	**Pala Paditëse dhe kontesti**	**Vlera e Kontestit**
1	Rosa Security - (Shkëputje e Kontratës)	2,350.00 €
2	Eliesa - (Kompenzim dëmi)	12,819.00 €
3	Mirjana Lazevic – (Kompenzim dëmi)	3,100.00 €
4	Bashkim Viseshella – (Kompenzim dëmi)	550.00 €
5	Naim Mujaj – (Pasurim i pabazë)	1,650.00 €
6	Gjelosh Vataj – (Kthimi në punë dhe kompenzim pagash)	24,439.87 €
7	Raza Shaqiri – Kompenzim për shpronësim (Fabrika Shkabaj – shpronësim i plotë)	134,228.00 €
8	Raza Shaqiri – Kompenzim për shpronësim (Fabrika Shkaba – shpronësim me servitutj)	13,825.00 €
	Totali	**192,961.87 €**

Kontratat me kushte të pavolitshme

Detyrimet aktuale që lindin nën kontratat me kushte të pavolitshme njihen dhe maten si provizione. Një kontratë me kushte të pavolitshme është konsideruar të ekzistojë kur Kompania ka një kontratë në të cilën kostot e pashmangshme të përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës tejkalojnë përfitimet ekonomike që priten të pranohen nga kontrata.

Para se një provizion i veçantë për një kontratë me kushte të pavolitshme është themeluar, një kompani njeh çdo humbje nga zhvlerësimi që ka ndodhur mbi pasuritë dedikuar për këtë kontratë.

Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të hyrat e interesit mbi llogaritë rrjedhëse. Të ardhurat nga interesi njihen kur ato ndodhin në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje), duke përdorur metodën e interesit efektiv . Shpenzimet finnciare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huazimet dhe humbjet nga rënia në vlerë të njohura si pasuri financiare (nëse ka).

Shpenzimet e huamarrjes

Kostot e huamarrjes drejtëpërdrejtë të atribueshme për blerjen, ndërtimin ose prodhimin e pasurive të ndërlidhura, të cilat janë pasuri që domosdoshmërisht marrin një kohë të gjatë për të gjen të gatshme për përdorimin e tyre të synuar ose të shitjes, janë shtuar në koston e këtyre pasurive, deri në kohën kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar apo për shitje.

Të gjitha shpenzimet e tjera të huamarrjes njihen në fitim ose humbje në përiudhën në të cilën ato ndodhin.

Tatimi

Tatimi mbi fitimin paraqet shumën e tatimit aktualisht të pagueshëm dhe tatimin e shtyer. Shpenzimi mbi tatimin në fitim përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura tjera gjithëpërfshirëse.Tatimi aktual është tatimi që pritet për tu paguar ose arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen për vitin, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.
Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën kompania pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyej vlerën kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve të saj. Tatimi i shtyrë është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato ndryshojnë, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e miratuar në ditën e raportimit.
Tatimi i shtyrë njihet si pasuri për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit do të përdoret ndryshimi i përkohshëm.Tatimi i shtyrë si pasuri rishikohet në secilën datë të raportimit dhe reduktohet në masën që kjo nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen. Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë Kompania merr parasyshë ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse taksa dhe interesa të tjera mund të ngarkohen. Kompania beson që shumat e njohura për detyrimet tatimore janë adekuate për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit tatimor dhe përvojë paraprake. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozimet dhe mund të përfshijë një seri të vendimeve rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacion i ri mund të jetë në dispozicion që i shkakton Kompanisë për të ndryshuar vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; ndryshime të tilla të detyrimeve tatimore do të ndikojnë në shpenzimin për tatimin në periudhën që një përcaktim i tillë është bërë.

FINAL

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një numër i politikave dhe shpalosjet e kontabilitetit të Kompanisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për të dyja, pasuritë dhe detyrimet financiare dhe jofinanciare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe të shpalosjes duke u bazuar në metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme informacioni i mëtejshëm mbi supozimet e bëra gjatë përcaktimit të vlerave reale është shpalosur në detyrimet specifike të pasurisë ose detyrimit përkatës.

Të arkëtueshmët tregtare dhe të tjera

Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, llogaritet si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme, skontuar me normën e interesit të tregut për pasuritë ngjashme në datën e raportimit.

Detyrimet financiare jo derivative

Vlera e drejtë, e cila është e përcaktuar për qëllime të shpalosjes, llogaritet në bazë të vlerës aktuale të rrjedhave monetare të principalit dhe interesit, të zbritur për normën e tregut të interesit në datën e raportimit.

Vlerësimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Jetët e dobishme të pronës, impianteve dhe pajisjeve

Siç përshkruhet në shënimin 3.6. më sipër; Kompania rishikon jetëgjatësinë e pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave apo faktor të tjerë mund të ndikojnë në jetët e dobishme të pasurive dhe në përputhje me rrethanat mund të ndryshojnënë vlerë të konsiderueshme vlerën kontabël neto të pasurive.

Provizionet për rënien në vlerë të llogarive të arkëtueshme dhe të shlyerjes së inventarëve Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania e bën vlerësimin për rikthimin dhe realizimin e të arkëtueshmeve dhe inventarëve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti njeh një provizion të përshtatshëm për rënien në vlerë të llogarive të arkëtueshme dhe të inventarëve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

Tatimi

Ngarkesa e tatimit të Kompanisë në aktivitetet e zakonshme është shuma e totalit të ngarkesave tatimore aktuale dhe të shlyera. Llogaritja e pagesës totale tatimore të Kompanisë domosdoshmërisht përfshinë një shkallë të vlerësimit dhe gjykimit në lidhje me zëra të caktuar, trajtimi tatimor i të cilëve nuk mund të përcaktohet përfundimisht derisa është arritur një rezolutë me autoritetin tatimor përkatës, ose, sipas rastit, nëpërmjet një procesi formal ligjor. Zgjidhja përfundimtare e disa prej këtyre zërave mund të ketë ndikim material në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe/ ose variancave në rrjedhën e parasë.

FINAL

PASURITË E PAPREKSHME

Pasuritë e pa Prekshme	**Blerjet 2017**	**Blerjet 2018**
Software	105,332	62,939.07
Paisjet e IT-se	21,082	18,643.73
Total	**126,414**	**81,582.8**

PASURITË

	Blerjet 2017	**Blerjet 2018**
G-Paisjet e Makinerise 20 %	8,437,499	21,105.95
G-Paisjet e Makinerise 10 %	-	1,669,435.02
H-Paisjet e Mirembajtjes 20 %	-	238,039.50
I -Automjetet 20%	43,099	2,800
K- Paisjet e Zyreve 20%	32,554	225
L- Mobiljete e Zyreve 20%	5,223	5,677
Total	**8,518,375**	**1,937,282**

	Zhvlerësimi 2017	Zhvlerësimi - 2018
A-Toka 0 %	-	-
B-Ndertesat dhe strukturat ndertimore-5 %	951,192	1,196,045.09
C-Rrjeta e Ujesjellesit-5%		2,797,776.11

	2,319,754	
D-Rrjeta e ujerave te ndotura 5%	436,892	479,046.01
E-Kyqjet ne Ujesjelles 5%	192,116	192,115.74
F-Ujematesit 20 %	573,934	485,383.94
G-Paisjet e Makinerise 10%	508,787	989,606.25
G-Paisjet e Makinerise 20 %		49,928.04
H-Paisjet e Mirembajtjes 20 %	10,737	35,254.50
I -Automjetet 20%	120,046	108,233.79
J- Paisjet e TI 20%	164,105	178,439.32
K- Paisjet e Zyreve 20%	11,498	12,424.74
L- Mobiljete e Zyreve 20%	16,845	15,066.02
Total	**5,305,905**	**6,539,319.5**

LLOGARITË E ARKËTUSHME TREGTARE

Llogarite e arketueshme	**2017**	**2018**
Bleresit e sherbimeve te Faturimit	46,342,198.39	46,774,844.83
Falja e Borxheve sipas ligjit (2016-2017)		8,648,529.88

	8,648,529.88	
Korigjimi i vleres se llog te arketu.	-41,508,912.14	-41,539,349.14
Sherbimet -Shitjet tjera (kyqjet, taksat)	139,510.20	139,510.20
Total	**13,621,326.33**	**14,023,535.77**

TE ARKËTUESHMET TJERA

Te arketueshme tjera	**2017**	**2018**
Paradheniet-avanset	7,216.71	7,216.71
Paradhenie per investime kapitale	537,771.98	571,965.86
Paradhenjet per sigurimin e automjeteve	11,548.32	10,481.14
Paradhenjet per qira	25,681.42	15,348.09
Paradhenjet per sherb.te internetit-Kujtesa	48.56	48.56
Paradhenie per Tatim ATK	57,402.44	117,082.44
Paradhenjet per fazen e dyte-KFW	2,855,672.15	
Bleresit-Shitjet tjera	106,038.49	106,038.49
Kyqja ne rrjetin e Ujesjellesit dhe Kanalizimit		6,702.40

FINAL

	6,702.40	
Kerkesat ndaj ATK-se (2001-2010)	647,888.55	647,888.55
Kerkesat ndaj Grantit Faza II-KFW(10862500.00)		161,000.00
Kerkesat ndaj Kredise-Faza II KFW(6 Milion)	-192,405.10	
Kerkesa per kamate dhe dividente	4,680.00	11,502.57
Kerkesa ndaj personelit	-94,934.08	10,524.32
Ndalesa per Materiale	8,578.32	7,473.04
Kerkesat tjera punetoreve (akontacion,kredi,kusur)	86,732.89	87,332.89
Kerkesat Tjera(Vjedhja e Arkes)	67,002.67	67,002.67
Rezervimet per qirane e papaguar	814.90	814.90
Total	**4,136,440.62**	**1,828,422.63**

PARAJA E GATSHME DHE NE BANKË

* PARAJA E GATSHME DHE NË BANKË	31.12.2017	31.12.2018
Paraja në arka		4,835.11
Paraja në Banka		4,314,657.2
Total	**5,224,093**	**4,319,492.31**

FINAL

Më 31.12.2018 paraja në bankë përfshinë 4,314,657.2 Euro

NLB-Prishtina	101,130.73
NLB-Podujeve	48,208.24
Nlb-Gllogovci	33,553.87
Nlb-Lipjani	103,605.77
RBKO-Prishtina	47,277.95
PCB-Prishtina	43,668.63
BpB-Banka private e bisnesit	291,078.25
TEB-Prishtina (20-11-0000248619-16)	128,216.59
POS-TEB (20-11-0000296247-13)	12,847.09
BE-Prishtina (1401000000587708)	52,090.57
BKT-Depozitat (1901377870041109)	0.00
BKT-Prishtina (1902377870041156)	56,394.06
BE-Depozitat 20-11-0000248619-16	820,000.00
BKT-Donacionet-1901377870041206	2,250,629.84
Teb-depozitat	0.00
NLB-Depozitat 17-01-0639000013.20	0.00
POS-BE	13,391.51
Bkp-Banka Kreditore e Prishtines	0.00
Permirsime	0.00
Teb-Dollar	0.00
BQK-Servitutet	299,580.00
BPB-DEPOZ	0.00
Konto kalimtare	12,984.10

Depozitat e afatizuara kanë normen e interesit vjetor prej:

520,000.00€ me normë interesi 2.1% dhe 300,000.00€ me normë të interesit 2.3%

FINAL

KAPITALI AKSIONAR

KAPITALI AKSIONAR	31.12.2017	31.12.2018
	25,000	25,000

Rezervat	31.12.2017	31.12.2018
Total	72,620,753.00	72,710,753.00

Më 31 Dhjetor, 2018 KRUP sh.a. përmban 100% të kapitalit aksionar të kompanisë. Pronari i vetëm i KRUP SH.A është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pasurite e pa levizshme	31.12.2017	31.12.2018
Toka	18,412,200.00	18,502,200
Pasuri e Patundshme-Servituti Tokësor	523,551.02	554,051.02
Ndërtesat dhe Struktura ndërtimorë	22,470,401.29	24,553,593.56
Rrjeta e ujësjellësit	52,768,400.35	58,469,504
Rrjeti i ujërave të ndotura	8,737,841.18	10,423,992
Kyqjet në rrjetin e ujësjellësit	3,842,314.63	3,842,315
Ujëmatësit	3,887,317.62	4,436,520
Objektet ndërtimore nëntokësore	489,976.71	818,575.30
Total	111,132,002.80	121,599,246

FINAL

Stoqet

Stoqet	2017	2018
Materiali hargjues	1,394,155.20	1,405,035.66
Lendet djegese	22,198.40	37,097.77
Mjetet mbrojtese ne pune	0.00	0.00
Inventari i imet	16,298.57	15,174.65
Auto gomat	0.00	828.82
Materiali i zyreve	2,085.07	1,890.70
Pjeset rezerve	10,082.73	10,053.61
Materiali hargjues per kemikalje dhe reagenca	39,810.49	0.19
Materialet e dhuruara (Donacion)	358.00	358.00
Kalkulimi i Blerjeve	-38.80	-38.80
Materiali i ndryshem ne depo-Podujeve	15,295.45	15,295.45
Material i ndryshem ne depo-Lipjan	23,441.30	23,441.30
Materiali i ndryshem ne depo-Drenas	41,818.62	41,818.62
Dallimet ne çmime	-20,420.84	-20,420.84
Inventari i imet ne perdorim	61,544.14	61,544.14
Autogomate ne perdorim	10,098.49	10,098.49
Total	**1,616,726.82**	**1,604,359.01.76**

GRANTET E SHTYERA

KRU “Prishtina” sh.a. edhe gjatë vitit 2018 ka njohur të hyra të shtyera dhe ka njohur grante.

Garantët kanë qenë të orientuar në zgjerimin e rrjetës së ujësjellësit dhe ne ndërtimin e fabrikës se re ne Shkabaj si dhe në fusha të tjera në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit vite me radhë.

Gjatë vitit aktual janë njohur si të hyra nga grantet e shtyera vlera prej **2,1479,196.04**€, njëjta vlerë është përllogaritur edhe si shpenzim operativ (zhvlerësimi i aseteve) përkatësisht shpenzime operative te mirëmbajtjes.

TE HYRAT NGA GRANTET	31.12.2017	31.12.2018
TOTAL	1,171,777	2,149,196.04

TE HYRAT TJERA OPERATIVE

TE HYRAT TJERA OPERATIVE	31.12.2017	31.12.2018
TOTAL	181,927	43,539

Të hyrat nga shërbimi i ujit dhe ujërave të ndotura

KRU "Prishtina" sh.a. menagjimin e faturave për shitjen e ujit dhe ujërave të ndotura e bënë me modulin e faturimit.

Tarifa për ujë dhe ujëra të ndotura zbatohet si e tillënë vlerat që ka miratuar Zyra Rregulllative për Ujë dhe Mbeturina.

Faturimi bëhet mbi bazën e leximit të matësve të ujit përkatësisht metodës afforfe për konsumatorët që nuk kanë ujëmatës-përkatësisht nuk mund të bëhet leximi i të njejtit.

Te hyrat nga faturimi	11,172,882.34
Te hyrat nga faturimi per kanalizim	1,227,236.81
Te hyrat nga taksa fikse	1,739,982.16
Te hyrat tjera nga Faturimi (kyqjet , taksat)	126,900.00
Total	**14,267,001.31**

KREDIA NGA KFW

KREDIA NGA KFW	31.12.2017	31.12.2018
Long term loan from Kfw(6 Mil)	6,000,000.00	6,000,000.00
Long term loan from Kfw -(20Mil)	14,445,000.00	12,223,000.00

Fitimi përkatësisht humbja e vitit fiskal

Fitimi/Humbja per periudhen 2018 eshte para tatimit në fitim (751,015,) Kompania ka realizuar të gjitha aktivitet gjatë vitit dhe ka shtuar vleren e ndërmarrjes dhe ka dalur me humbje.

	31.12.2017	31.12.2018
Fitimi-Humbja operative	529,437	(764,077)
Tëhyratngainteresinëdepozitatbankare	4,680	13,062.57
Fitimi-Humbja para tatimit	534,117	(751,015)
Shpenzimet e tatimit në fitim	(53,412)	0
Fitimi / Humbja e vitit	480,705	(751,015)

Shpenzimet vjetore të amortizimit dhe zhvlerësimit

Assetet e KRU "Prishtina" sh.a. mbahen, menaxhohen dhe kontabilizohen në modulin e vecantë në kuadër të softuerit "Navision"

Zhvlerësimi i aseteve është bërë në mënyrë drejtëvizore-lineare për të gjitha assetet.

Normat e zhvlerësimit janë nxjerrë nga Ligji për Tatimin në të ardhurat e korporatave nr. Nr. 05/L-029

Shpenzimet vjetore qe njihen si shpenzime të zhvlerësimit për vitin 2018 kapin vleren 6,539,319.55€uro.

Shpenzimet e zhvleresimit dhe amortizimit	31.12.2017	31.12.2018
TOTAL	(5,305,904)	(6,539,319.55)

FINAL

Shpenzimet e taksës për ujin e marrë nga liqenet e Badovcit dhe Batllaves

MMPH për ujin të cilin e marrin nga liqenet e Badovcit dhe Batllavës na faturon me një taksë vjetore për ujin e ditribuar. Me vite me radhë për shkak qe MMPH nuk ka dorëzuar faturat, nuk janë regjistruar këto taksa në kontabilitet. Në vitin 2018 janë regjistruar taksat e faturuara nga MMPH.

Vitet	**Shuma**
2011	45,063.63
2012	45,690.89
2013	44,307.50
2014	37,159.40
2015	57,529.29
2016	57,529.29
2017	78,672.40
Totali	**365,952.40**

Këto shpenzime të cilat janë krijuar vite me radhë dhe janë regjistruar në vitin 2018 kanë ndikuar që fitimi I këtij viti- vitit 2018 të ulet per shumën 365,952.40€

Shpenzimet e borxhit të keq

Vlera e borxhit të keq e prezantuara në Pasqyrën e të ardhurave është treguar në vlera neto, duke zbritur tatimin në vlerë të shtuar.

Borxhi i keq është bërë me metodën e provizionimit të përgjithshëm.

Për provizionimin e borgjeve të këqija kemi siguruar të gjitha dëshmitë si: vërejtjet, thirrjet për pagesë, raportet e shkyqjeve, njoftimet përmes mediave, rastet që kane shkuar te përmbaruesi. Duke u bazuar në vlerën e borgjeve të papaguara që i kemi ndjekur të gjitha proceduarat sipas Ligjit Nr. 05/L-029 Për

FINAL

Tatimin në të ardhurat e korporatave kemi llogaritur vlerën 30,437€ në emër të shpenzimeve të borgjit të keq.

Shpenzimet e provizionimit tëborxhit të keq	31.12.2017	31.12.2018
TOTAL	(869,929)	(30,437)

* LLOGARITE E PAGUESHME TREGARE DHE TE TJERA

Llogarite e pagueshme	**2017**	**2018**
Furnitoret nga afarizmi i rregullt	1,479,294	1,378,362

Detyrimet ndaj furnitorëve për veprimtarinë e rregullt të KRU "Prishtina" sh.a. përfaqsojnë kryesisht detyrimet e muajve të fundit për të cilat nuk ka skaduar afati i pagesës apo nuk jane kryer punimet ne teren.(Parimi i akrualitetiti)

Pagat e pagueshme dhe tatimi i pagueshem-TVSH

Pagat e pagueshme përfshirë tatimet dhe kontributet nga pagat janë në vlerë prej 835,846.00 € të cilat pritet të paguhen pas skadimit të vitit fiskal (parimi i akrualitetit).

PAGAT DHE TATIMI I PAGUESHEM	31.12.2017	31.12.2018
Total	677,473	835,846

Shpenzimet e personeli	31.12.2017	31.12.2018
Total	5,036,900	5,137,160

Resurset njerzore përkatësisht pagat e tyre menagjohen me modulin e veqantë në kuadër të softuerit "Navision".

Kalkulimi dhe pagesa e pagave bëhet në bazë të kontratës individuale.

Pagat bruto i nënshtrohen të gjitha tatimeve dhe taksave të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu shtesat dhe kompenzimet tjera paguhen në përputhje me Kontratën kolektive dhe Rregulloren mbi Ligjin themelor të punës në Kosovë.

FINAL

Distribuimi dhe Faturimi ne m3

	31.12.2017	31.12.2018
Distibumi I ujit m3	52,087,383	51,743,595
Faturimi I ujit m3	22,301,582	21,841,206
Humbjet	57%	58%

Shpenzimet e materialeve për mirëmbajtje

Shpenzimet e materialeve dhe pjesëve të ndërrimit për mirëmbajtjen e rrjetit dhe makinerisë përfaqësojnë një kategori thelbësore të shpenzimeve. Këto shpenzime adresohen përmes procedurës së hyrje-daljeve në depon qëndrore (Prishtinë) dhe depove që aktualisht kanë mbetur nëpër NJOU-të.

Shpenzimet e Materialit Harxhues	337,632.18
Shpenzimet e mjeteve te mbrojtjes ne pune-depo	22,946.29
Shpenzimet e inventarit te imte-depo	13,222.67
Shpenzimet e autogomave-depo	8,488.90
Shpenzimet e materialit administrativ-depo	22,639.79
Shpenzimet e pjeseve rezerv-depo	5,445.07
Shpenzimet e materialit-kemikalje dhe reagenca	272,344.98
Shpenzime materiale Lipjan	97.90
Shpenzime materiale Podujeve	72.47
Shpenzime materiale Drenas	177.90
Shpenzime materiale Shtime	161.38
Shpenzimet e analizave dhe testet e ujit	610.00
Shpenzimet per analiza shendetsore -punesuarit	15,595.00
Shpenzimet transportit te mallerave e sherbimeve	805.00
Shpenzimet transportit publik vajtje-ardhje n'pune	3,900.00
Shpenzimet transportit,fjetjes n'udhetime zyrtare	4,627.88
Shpenzimet e akomodimit gjate udhetimit zyrtar,	816.94

FINAL

Shpenzimet tjera gjat udhtimit zyrtar dhe akomodim	29,871.15
Total	**739,461.50**

Shpenzimet e jashtme kontraktuese

Përfaqsojnë një kategori të madhe dhe të shumllojshme të shpenzimve që palët e treta bëjnë në interes tëKRU "Prishtina" sh.a. duke potencuar disa:Tatimi në pronë,Taksa vjetore e licencimit-ZRRUM,Anëtarësitë,Sigurimi fizik i objekteve etj (shiko tabelën).

Shpenzimet e telefonise fikse	8,600.05
Shpenzimet e telefonise mobile-Vala	21,828.81
Shpenzimet e telefonise mobile-Internet	8,219.08
Shpenzimet tjera per PTK dhe postave tjera	290.60
Shpenzimet e licences per ZRRUM	163,233.48
Shpenzimet e licences per programe	200.00
Shpenzimet per shfryt.frekuencave te radiolidhjeve	980.00
Taksa vjetore per Ëeb faqe	20.00
Tatimi ne prone	1,164.13
Tatimi ne fitim	624.00
Tatimi ne burim per qira,lojera fati etj	4,691.42
Taksa komunale e firmes	3,450.00
Shpenezimet e doganes	440.00
Sherbimet e jashtme kontraktuese	3,350.00
Taksa-Tarifa menaxhuese e kredise	942.33
Anetaresia ne SHUKOS	16,600.00
Anetaresite tjera	144.00
Shpenzimet e barjes se mbeturinave	10,305.88
Shpenzimet e Ujit per pije	120,106.28
Shpenzimet e ushqimit-mbi pagesen e rregullt	685.08
Shpenzimet e reprezentacionit	12,860.03

FINAL

Shpenzimet per sigurimin fizik te objekteve	851.62
Sherbimet e ndryshme kontrakturse (Sig.per qkyqje)	8,060.00
Shpenzimet per marrjen me qera te objekt.ndertimor	54,950.75
Shpenzimet per marrje me qera te TI (fotokopje,)	9,409.90
Shpenzimet per marrjen me qera te paisjeve tjera	699.00
Shpenzimet per sigurimin e automjeteve	19,046.12
Shpenzimet per rexhistrimin e automjeteve	5,289.14
Taksa komunale per shfrytezimin e rrugeve publike	800.00
Shpenzimet per sigurimin e objekteve ndertimore	4,139.50
Taksa rrugore e Republikes se Kosoves	5,883.75
Taksa ekologjike	1,330.00
Taksa per leje ndertimi te objekteve	655.95
Shpenzimet per transfere te transakcioneve bankare	102,661.9
Shpenzimet e shkollimit	394.00
Shpenzimet e trajnimit,seminare,kotizim etj	11,646.35
Shpenzimet per perfaqsimin ligjor-avokati,auditimi	2,294.00
Shpenzime per ekspertiza,kataster,auditim,perkthim	3,370.17
Shpenzimet e reklames dhe propagandes	1,391.00
Shpenzimet e pervjetoreve, dhuratave, inaugurimeve	3,918.84
Shp. E denimeve, penaleve, gjobave,interesave etj.	76,293.33
Shpenzimet e miremajtjes se softverit	0.00
Shpenzimet e byfese	9,999.54
Shp. E shpronsimit-Servitutet(Fabrika e re)	912.16
Shpenzimet per ndihma solidare	1,075.00
Total	**703,805**

FINAL

Shpenzimet e interesit

Deri në vitin 2017 shpenzimet e interesit janë kapitalizuar me arsyen se investimet për të cilat janë marrë këto kredi kanë qenë të pa perfunduara. Në vitin 2018 keto shpenzime janë trajtuar si shpenzime operative per arsye se asetet per te cilat jane marre keto kredi jane perfunduar .

Shpenzimet e interesit perfshire edhe taksat menaxhuese per vitin 2018 jane 486,636.99€

Shpenzimet për sport,rekreacion,kulturë,taksa gjyqësore dhe ndihma solidare

Pershkrimi	Vlera
Shpenzime per aktivitete sportive	325.00
Shpenzime te ndihmave solidare(pensione,donacione,	7,317.10
Total	**7,642.1**

Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit

Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimet nga dëmtimet eventuale janë sipas bartësve në vijim:

Objektet ndertimore	5,357.69
Rrjeti i ujit	508.47
Paisjeve	40,991.97
Automjetet	69,663.58
Shpenzimet e mirembajtjes dhe riparimit-TI	210.55
Shpenzimet e mirembajtjes dhe rip. te automjeteve	176.35
Mirmbajta e paisjeve-montim dhe demontim	91.00
Total	**116,999.61**

Te dalurat financiare dhe transferi i rezultatit financiar

Shpenzimet e ndryshme	12,803.53
Shpenzimet per shtypin ditor	70.00
Shpenz.gjyqesore-administrative dhe taksa tjera	6,010.73
Mjete themelore jashte perdorimit	3,026.62
Kontrat mbi veper (te dalurat)	2,171.00
Total	**24,127.00**

FINAL

FINAL